



Акционерско друштво во државна сопственост  
за вршење на дејноста давање услуги во  
воздухопловната навигација

Shoqëri aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e  
veprimtarisë dhënie të shërbimeve të navigacionit ajror

# Raport vjetor për punën e “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022



“Босфор” Бр. 7, Мралино, Илинден  
Република Северна Македонија  
Тел: +389 2 3148100 Факс: +389 2 3148239  
E-mail: [info@mnavigation.mk](mailto:info@mnavigation.mk)



“Bosfor” Nr. 7, Mralino, Ilinden  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
Tel: +389 2 3148100 Fax: +389 2 3148239  
E-mail: [info@mnavigation.mk](mailto:info@mnavigation.mk)

## IDENTIFIKIMI I DOKUMENTIT

**Përshkrimi i dokumentit:** Raport vjetor për punën e "M-NAV" SH.A. - Shkupi për vitin 2022, i cili përfshin Analizën e trafikut ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Analizën e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2022, Analizën e të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, Investimet dhe zhvillimi, Politika e resurseve njerëzore, Bashkëpunimi rajonal, FAB's-i, Përbushja e objektivave të përcaktuara për vitin 2022, Treguesit kryesorë të realizimit (KPI), si dhe Raportet financiare të reviduara të "M-NAV" SH.A. - Shkup për vitin 2022.

**Titulli:**

**„M-NAV“ SH.A. - SHKUP  
RAPORT VJETOR PËR PUNËN E REALIZUAR GJATË VITIT 2022**

**Numri referues:**

MNV-810-103.05

**Numri i edicionit:**

1.0

**Data:**

26/04/2023

**Ekstrakti:**

“Këshilli drejtues i "M-NAV" SH.A. – Shkup, gjatë vitit 2022 punën e tij e fokusoi drejt përbushjes së vazhdueshme të kushteve të përcaktuara me Certifikatën e aftësisë për kryerjen e shërbimeve të navigacionit ajror si dhe drejt përbushjes së vazhdueshme të qëllimeve operative të Shoqërisë gjatë vitit 2022:....”

**Fjalët kyçe:**

Vëllimi i trafikut në vitin 2022, synimet operative të Shoqërisë, siguria dhe sigurimi, të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2022, të hyrat dhe shpenzimet e realizuara për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, treguesit kryesorë të realizimit, investimet, projektet...

**Statusi i dokumentit:**

Versioni i punës

Versioni final

Edicion i publikuar

**Klasifikimi:**

Dokument për përdorim të brendshëm  
Dokument publik  
I besueshëm

**Lokaliteti:**

Shkup

## PRANIMI I DOKUMENTIT

Në tabelën vijuese janë theksuar autorët dhe personat që kanë përpiluar/kontrolluar/lejuar këtë dokument

Funksioni	Emri, mbiemri dhe nënshkrimi	Data
Përpilues	Igor Andreevski Këshilltarë i pavarur për kontrollim të buxhetit	
Kontrollues Aspekti - cilësorë	Leonora Shala Shef i Seksionit për cilësi – siguri në suaza të Seksionit për sistem të integruar të menaxhimit	
Ka dhënë pajtimin	Jovica Jovanovski Drejtues i Seksionit për për sistem të integruar të menaxhimit	
Kontrollues Aspekti – i harmonizimit	Valentina Dimevska Drejtues i Seksionit për revizion të brendshëm	
Lejoi	D-r Hasim Deari Извршен Директор за финансиски работи, правни работи, развој и инвестиции Drejtor Ekzekutiv për çështje financiare, ligjore, zhvillim dhe investime  Fahrudin Hamidi Претседател на Управен одбор Kryetar i Këshillit Drejtues	

## Përmbajtja

---

I. Parathënie .....	5
II. Rezyme.....	8
1. Analiza e trafikut ajrorë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	11
2. Analiza e të hyrave dhe shpenzimeve në “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 .....	16
3. Analiza e të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara në “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 me krahasimet përkatëse të vitit 2021.....	21
4. Investime dhe zhvillim.....	28
5. Politika e resurseve njerëzore.....	35
6. Bashkëpunimi rajonal, FAB’s.....	37
7. Përbushja e qëllimeve të përcaktuara për vitin 2022.....	38
8. Indikatorët kryesor të realizimit (KPI).....	47
9. Raportet financiare të reviduara të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022.....	58

### Shtojca:

1. Llogaria vjetore “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022;
2. Raporti i Revizorit të pavarur – Grand Tomton Shkup me Raportet financiare të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022;
3. Formularët për njoftimin financiarë të ndërmarrjeve publike, shoqatave aksionare dhe të entiteteve të tjera.

## I. Parathënie

Në pajtim me nenin 60 të Ligjit për navigacionin ajrorë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 14/06, 24/07, 103/08, 67/10, 24/12, 80/12, 155/12, 42/14, 97/15, 152/15, 27/16, 31/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 220/19), për kryerjen e shërbimeve të navigacionit ajror, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut themeloi shoqërinë aksionare me një aksionar, shtetin - ofrues i shërbimit të navigacionit ajror, në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare. Mënyra e themelimit, veprimtaritë dhe mënyra e menaxhimit rregullohen me aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

Në seancën e mbajtur më datën 16.10.2008, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi Vendimin për fillimin e procedurës për themelimin e Shoqërisë Aksionare në pronësi shtetërore për kryerjen e veprimtarisë së ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror me nr. 19-4602/1.


Në pajtim me Gjendjen aktuale të lëshuar nga ana e Regjistrimit qendror, data e themelimit të Shoqërisë "M-NAV" SH.A. - Shkup është 04.11.2008.

Kryegjësja themelore e Shoqërisë është në shumën prej 1.552.034.000,00 denarë ose 25.226.275,71 euro, të ndarë në 1.552.034 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1.000,00 denarë për një aksion.

Sipas Statutit të "M-NAV" SH.A. – Shkup, Menaxhimi i Kompanisë në Shkup është i organizuar sipas një sistemi dy nivelesh. Kompania ka një Bord Drejtues dhe një Bord Mbikëqyrës. Bordi drejtues përbëhet nga tre anëtarë:

Në pajtim me Statutin e "M-NAV" SH.A. – Shkup, menaxhimi i Shoqërisë është i organizuar sipas një sistemi dy nivelesh. Shoqëria posedon Këshillin drejtues dhe Këshillin mbikëqyrës. Këshilli drejtues përbëhet nga tre anëtarë:

1. Fahrudin Hamidi, i zgjedhur me Vendim të Këshillit mbikëqyrës të "M-NAV" SH.A. - Shkup nga data 30.10.2020, i cili udhëheq, organizon dhe është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve në suaza të navigacionit ajror dhe mban titullin - Drejtor ekzekutiv për navigacionin ajror. Personi i emëruar është edhe Kryetar i këshillit drejtues.
2. Vladko Krstevski i zgjedhur me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të "M-NAV" SH.A. - Shkup nga data 20.12.2019, i cili udhëheq, organizon punën dhe është përgjegjës për mjetet teknike në suaza të navigacionit ajror dhe mban titullin - Drejtor ekzekutiv për teknike të navigacionit ajror.
3. Migjen Salmani i zgjedhur me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të "M-NAV" SH.A. – Shkup nga data 26.09.2011, 18.09.2015 dhe 18.09.2019, i cili udhëheq dhe kryen punët financiare, punët juridike, zhvillimin dhe investimet dhe është përgjegjës për punën financiare, punët juridike, zhvillimin dhe investimet dhe mban titullin - Drejtor ekzekutiv për punët financiare, çështjet juridike, për zhvillim dhe investime. Personi i emëruar e kryen funksionin deri më datën 13.03.2023. Dr. Hasim Deari i zgjedhur me Vendim të Këshillit mbikëqyrës të "M-NAV" SH.A. - Shkup nga data 13.03.2023, i cili udhëheq dhe kryen punët financiare, punët juridike, zhvillimin dhe investimet dhe është përgjegjës për punët financiare, punët juridike, zhvillimin dhe investimet dhe mban titullin - Drejtor ekzekutiv për punët financiare, punët juridike, për zhvillim dhe Investime.



### **Misioni**

**T**ë sigurohet nivel i lartë i shërbimeve dhe në mënyrë permanente dhe të vazhdueshme të përmirësohet siguria, rregullsia dhe efikasiteti i trafikut ajror me përdorimin optimal të burimeve njerëzore dhe teknike në dispozicion dhe me shpenzime minimale të sigurohet një cilësi e lartë e shërbimeve të navigacionit ajror në suaza të hapësirës së caktuar ajrore në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, duke u kujdesur për mjedisin jetësor.


### **Vizioni**

**V**endosja e “M-NAV” “SH.A. – Shkup si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, me potencial të sigurimit të vazhdueshëm të nivelit të lartë të shërbimeve të sigurt, të rregullta, ekspeditive dhe efikase për shfrytëzuesit e hapësirës ajrore si dhe ofrues i shërbimeve lidhur me navigacionin ajror, i cili funksionon në pajtim me rregulloret e Single European Sky, të aftë për tu adaptuar me shpenzime minimale ndaj Rregulloreve të reja Evropiane, gjë që do të rezultojë me sigurimin e pozitës së qëndrueshme dhe përmirësimin e performanceve të realizimit, në suaza të Bllokut rajonal të “Functional Airspace Block”.

## Vlerat

Përbushja e standardeve më të larta të funksionimit profesional dhe të cilësisë së shërbimeve	
Përkushtimi i njerëzve, si kapital më i rëndësishëm i organizatës	
Sigurimi i mjedisit të punës me kushte përkatëse për rritjen e produktivitetit dhe motivimit të të punësuarve	
Bashkëpunimi me të gjitha palët e interesuara	
Menaxhment me përgjegjësi, udhëheqje racionale me të gjitha resurset e organizatës	
Avancim i vazhdueshëm në të gjitha aspektet e funksionimit	

„M – NAV” SH.A. – Shkup, realizon të ardhura pronësore nga funksionimi i saj në bazë të:



**N**ë pajtim me nenin 53 paragrafi 4 të Ligjit për navigacion ajror (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 14/06, 24/07, 103/08, 67/10, 24/12, 80/12, 155/12, 42/14, 97/15, 152/15, 27/16, 31/16 dhe 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 220/19) - “(4) Për marrjen e vërtetimit për aftësinë për të ofruar shërbimet e navigacionit ajror, ofruesi i shërbimit duhet të posedojë personelin e nevojshëm, pajisjet, si dhe të plotësojë kushte të tjera të veçanta të nevojshme për funksionim të sigurt dhe të rregullt”.

Në përputhje me këtë nen dhe në lidhje me kushtet e përcaktuara në Dekretin për mënyrën e ofrimit të shërbimeve lidhur me navigacionin ajror, si dhe kushtet e veçanta në lidhje me personelin e nevojshëm, pajisjet dhe kushtet e tjera të veçanta të domosdoshme për funksionimin e sigurt dhe të rregullt (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 08/2018), në periudhën e kaluar, në vazhdimësi,

Agjencia e navigacionit ajror civil të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konfirmon se "M-NAV" SH.A. - Shkup, si ofruer i shërbimeve të navigacionit ajror, i plotëson të gjitha kërkesat dhe kushtet në fuqi që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror si dhe posedimin e aftësisë për t'i ofruar kërkesat dhe kushtet e lartpërmendura, përkatësisht:

- Në muajin mars të vitit 2012 nga ana e Agjencisë për navigacion ajror civil, është dhënë Vërtetimi për posedim të aftësisë për ofrim të shërbimeve lidhur me navigacionin ajror me numër MK-01-2012/ANSP;
- Në muajin mars të vitit 2014 nga ana e Agjencisë për navigacion ajror civil, është dhënë Vërtetimi për posedim të aftësisë për ofrim të shërbimeve lidhur me navigacionin ajror me numër MK-01/2014ANSP;
- Në muajin mars të vitit 2016 nga ana e Agjencisë për navigacion ajror civil, është dhënë Vërtetimi për posedim të aftësisë për ofrim të shërbimeve lidhur me navigacionin ajror me numër MK01-2016/ANSP;
- Në muajin mars të vitit 2018 nga ana e Agjencisë për navigacion ajror civil, është dhënë Vërtetimi për posedim të aftësisë për ofrim të shërbimeve lidhur me navigacionin ajror me numër MK01-2018/ANSP;
- Në muajin mars të vitit 2020 nga ana e Agjencisë për navigacion ajror civil, është dhënë Vërtetimi për posedim të aftësisë për ofrim të shërbimeve lidhur me navigacionin ajror me numër MK01-2020/ANSP;
- Në muajin mars të vitit 2022 nga ana e Agjencisë për navigacion ajror civil, është dhënë Vërtetimi për posedim të aftësisë për ofrim të shërbimeve lidhur me navigacionin ajror me numër MK01-2022/ANSP.

Të gjitha Vërtetimet e lartpërmendura janë dhënë me periudhë të vlefshmërisë prej dy viteve.

## *II. Rezime*

Këshilli drejtues i "M-NAV" SH.A. – Shkup, në vitin 2022, aktivitetet e veta i fokusoi drejt stabilizimit financiar dhe vazhdimin të projekteve që janë me rëndësi thelbësore për funksionimin dhe zhvillimin e pa penguar të shoqërisë në të ardhmen. Marrja e masave dhe aktivitetet për t'u kujdesur për zhvillimin e potencialit njerëzor, si pjesë më e rëndësishme e çdo organizate, me qëllim arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm në të ardhmen. Me harmonizimin e kapaciteteve pronësore me kërkesat e Network Manager, "M-NAV" SH.A. - Shkup ka arritur një rezultat solid në suaza të rrjetit evropian të trafikut ajror me një përqindje të trafikut që ka shënuar rritje prej gati 4% (5,5% overflights – fluturime transitorre) krahas nivelit të trafikut në vitin 2019, i cili merret si vit referencë në analizat e të gjithë faktorëve me relevancë në fushën e navigacionit ajror. Njëkohësisht është ruajtur edhe niveli i lartë i sigurisë dhe besueshmërisë së shërbimeve të navigacionit ajror, duke i tejkaluar në mënyrë pro-aktive sfidat e pritshme dhe ato të papritura. Si aktivitete më të rëndësishme do ti veçojmë:

- Koordinimi dhe informimi i vazhdueshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ministrive përkatëse për gjendjen aktuale dhe për aktivitetet e Shoqërisë;
- Me qëllim të mbylljes dhe rifinancimit me kushte më të volitshme kreditore të kredisë së lidhur me BERZH më datën 24.09.2013, "M-NAV" SH.A. – Shkup,



gjatë vitit 2022 ka finalizuar negociatat me BERZH, dhe pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën 29.07.2022 ka nënshkruar Kontratë të re të kredimarrjes me BERZH (në shumën prej 10.000,000.00 euro), si dhe Kontratën me Komercijalna banka SH.A. Shkup (me vlerë prej 5.000.000,00 euro). Në të njëjtën kohë, "M-NAV" SH.A. - Shkup pranoi mjete në vlerë prej 400,000.00 euro nga fondet e grandeve të BERZH, të cilat janë të destinuara për shërbime konsulente në realizimin e projekteve të BERZH, si dhe trajnime rifreskuese për kontrollorët për t'u kyçur në SECSI FRA (South East Common Sky Initiative Free Route Airspace).

- Ruajtja e standardeve dhe arritja e objektivave të përcaktuara sektoriale për vitin 2022 lidhur me sigurinë dhe ofrimin e cilësisë;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemeve dhe pajisjeve, optimizimi dhe menaxhimi i resurseve ekzistuese njerëzore si dhe i proceseve për punësim të kuadrove të reja që nevojiten për sigurimin e nivelit të pa penguar dhe të lartë të sigurisë së shërbimeve në suaza të navigacionit ajror;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me institucionet ndërkombëtare siç janë Eurocontrol, CANSO, IATA dhe të tjera, për harmonizimin e procedurave dhe organizimi i shoqërisë të jetë në përputhje me rregulloret në fuqi dhe me rregulloret që do të hyjnë në fuqi në të ardhmen;
- Vazhdimi i bashkëpunimit në kuadër të iniciativës për Organizatën e hapësirës ajrore në suaza të blloqeve funksionale (FAB - Functional Airspace Blocks), on-line në kuadër të takimeve të rregullta të Bluemed Fab;
- „M-NAV“ SH.A. - Shkup edhe gjatë vitit 2022 morri pjesë në sigurimin e mbështetjes teknike nga Hungaro Control (i cili është kompetent për ofrimin e shërbimeve lidhur me kontrollimin e fluturimeve për hapësirën e sipërme ajrore të Kosovës) me anë të sigurimit të sinjalit të radarit në Ohër dhe sinjalit komunikues nga sistemi i lokalitetit Gradishtë;
- “M-NAV” SH.A. - Shkup, përsëri realizimit të projekteve, njëkohësisht me sukses arriti që të ofrojë shërbimet e trafikut ajror në mënyrë të sigurt dhe efikas, duke i zbatuar lehtësimet e kërkuara për linjat e drejtpërdrejta - koncepti FRA dhe restriksionet e anuluar me qëllim të uljes së shpenzimeve të kompanive ajrore;
- Me qëllim të optimizimit të trafikut dhe planifikimit efikas të qarkullimit të trafikut ajrorë, "M-NAV" SH.A. - Shkup më datën 02.12.2021 iu bashkua iniciativës rajonale SECSI FRA (South East Common Sky Initiative Free Route Airspace), me këtë hapësira jonë ajrore u bë pjesë integrale e SECSI FRA, gjatë kësaj u implementua e ashtuquajtura – “cross-border Free Route Airspace” (Rruga e lirë ajrore ndërkufitare) me Shqipërinë, Serbinë, Malin e Zi, Bosnje dhe Hercegovinën, Kroacinë, Slloveninë dhe Austrinë. Me këtë u mundësua planifikimi aktiv i rrugës më të shkurtër, përkatësisht i rrugës më efikase të fluturimit, duke rezultuar në emetimin më të ulët të dyoksidit të karbonit dhe pjesëmarrjen aktive në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit jetësorë;
- Gjatë vitit 2022 si dhe në periudhën në vijim, Këshilli drejtues i "M-NAV" SH.A. - Shkup do të vazhdojë me përkushtim të plotë drejtë gjetjes së mënyrave për t'u përballur me sfidat financiare dhe menaxhimit me likuiditetin financiar të Shoqërisë, gjatë kësaj duke mbajtur llogari dhe duke u kujdesur për të siguruar rrjedhën e rregullt dhe të pa penguar të trafikut ajror, servisimin e obligimeve ndaj të punësuarve në pajtim me Marrëveshjen kolektive të "M-NAV SH.A. – Shkup, duke ruajtur nivelin e lartë të sigurisë së shërbimeve të navigacionit ajror;

- Në vitin 2022 "M-NAV" SH.A. - Shkup morri pjesë aktive përmes Ministrisë së transportit dhe Ministrisë së punëve të jashtme të RMV-së në drejtim të përpilimit të marrëveshjes ndërshtetërore, me të cilën u krijuan mundësitë e përcaktimit të zgjidhjes formale-teknike për ofrimin e shërbimit në një pjesë të hapësirës ajrore që i përket Republikës së Shqipërisë, e cila shfrytëzohet për aterrim efikas dhe të sigurt në aeroportin Shën Apostulli Pali në Ohër;
- Marrja e aktiviteteve të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajrorë për aeroplanët e NATO-s si dhe pjesëmarrja aktive në harmonizimin e rregulloreve të nevojshme me Ministrinë e mbrojtjes të RMV-së;
- Aktivitete të ndërmarra për realizimin dhe koordinimin me institucionet relevante për organizimin e stërvitjes së NATO-s "Swift Response 22" gjatë muajve prill dhe maj të vitit 2022. Stërvitja u realizua me sukses në suaza të matricës së paraparë dhe të planifikuar kohore;
- Në pajtim me rregulloren e BE-së me numër 1794/2006 për përcaktimin e një sistemi të përbashkët për pagesën e shërbimeve të navigacionit ajror, në shtojcën përcjellëse të "Vendimit për mënyrën e përcaktimit të lartësisë së kompensimit për shfrytëzimin e shërbimeve të navigacionit ajror dhe mënyrën e arkëtimit si dhe lartësinë dhe mënyrën e përcaktimit të pjesës së kompensimit për shfrytëzimin e shërbimeve të navigacionit ajror, të miratuar nga Qeveria e RMV-së, (Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 194/2019), të gjitha të hyrat e realizuara nga fluturimet transitore në vitin 2022 në shumën totale prej 22.478.936.27 euro janë bartur veçmas një pjesë në llogarinë e SH.A. "M-NAV" SH.A. – Shkup, kurse pjesa tjetër bartet në llogari të Agjencisë së aviacionit civil të RMV-së nga CRCO - Eurocontrol, si kompensim për financimin e shpenzimeve për shërbimet e fluturimeve transitore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Këto mjete janë përcaktuar gjatë vitit 2022 nga ana e Eurocontrol në raportin 16.80% për Agjencinë e aviacionit civil, dhe 83.20% për "M-NAV" SH.A. - Shkup (njoftimi nga ACV deri te Eurocontrol, me numër 05-1245/1 të datës 22.12.2021)".
- Siç mund të shihet nga raportet financiare të bashkangjitura si shtojca, "M-NAV" SH.A. – Shkup, në vitin 2022 shënon neto fitimin në shumën prej 136.956.913,99 denarë gjatë periudhës raportuese.

Me respekt,


**Kryetar i Këshillit Drejtues  
Fahrudin Hamidi**

## **1 Analiza e trafikut ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

**S**tabilizimi gradual i gjendjes lidhur me pandeminë Covid – 19 dhe anulimi i masave restriktive gjatë vitit 2022, shkaktoi rikthimin e trafikut sidomos në rajonin tonë për shkak të intensifikimit të udhëtimeve për pushimet vjetore drejt destinacioneve turistike. Në pjesën më të madhe gjatë 9 muajve të parë është

vërejtur një rritje e lehtë e trafikut krahasuar me vitin referues 2019. Në tabelën 1.1 të dhënë më poshtë, mund të vërehet se trafiku në vitin 2022 është kthyer mbi nivelin e vitit 2019, përkatësisht në përgjithësi ka tejkaluar nivelin e vitit 2019 për 4%.

**Tabela 1.1: Numri i përgjithshëm i trafikut të realizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës së viteve 2019 - 2022<sup>1</sup>.**




Në tabelën 1.2. të prezantuar më poshtë është prezantuar numri i përgjithshëm i fluturimeve transitore në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2022.

**Tabela 1.2: Numri i përgjithshëm i fluturimeve transitore në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës së viteve 2018 - 2022<sup>2</sup>**

<sup>1</sup> Burimi: Shkup FMP.

<sup>2</sup> Burimi: Shkup FMP.


LWSS overflights from 2018 to 2022



Dita me më shumë operacione në vitin 2022 është e shtuna, 6 gushti me gjithsej 1037 operacione.

Për një pasqyrë më të detajuar, në tabelën 1.3 më poshtë është prezantuar evolucionin e trafikut të përgjithshëm për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2022.


Tabela 1.3: Numri i përgjithshëm i trafikut të realizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës së viteve 2013 - 2022<sup>3</sup>



Në tabelën 1.4 të prezantuar më poshtë është prezantuar evolucionin mujor i trafikut të përgjithshëm për periudhën e viteve 2019-2022, në të cilën shihet qartë rritja e trafikut në vitin 2022 krahasuar me vitin referues 2019.

<sup>3</sup> Burimi: Shkup FMP.

**Tabela 1.4: Numri i përgjithshëm i trafikut të realizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën e viteve 2019 - 2022 sipas muajve<sup>4</sup>**



Kjo rritje e trafikut do të ishte edhe më e madhe nëse kushtet meteorologjike gjatë sezonit të verës do të ishin më të favorshme. Kushtet e pafavorshme të motit në një numër të konsiderueshëm të ditëve gjatë periudhës së verës shkaktuan vendosjen e rregulloreve kryesisht nga njësitë fqinje të kontrollit të trafikut ajror, por edhe nga ana jonë.

Si faktor shtesë që shkaktoi zvogëlimin e trafikut është edhe realizimi i projektit për implementimin e sistemit të ri VHF si pjesë e Planit për modernizimin e “M-NAV” SH.A. - Shkup. Zbatimi i këtij projekti në fillim të shtatorit në kohëzgjatjen prej dy javëve, gjegjësisht faza e zëvendësimit të radiove në radio sajtin e “Sollunska Glava”, në përputhje me rekomandimet e sigurisë, shkaktoi një kufizim të numrit të sektorëve në dispozicion nga tre në dy dhe një reduktim të kapaciteteve të sektorit “Lower”.


Për më tepër, konflikti luftarak dhe mbyllja e hapësirës ajrore mbi Ukrainën shkaktoi një fluktuim të trafikut ukrainas në jug të Ukrainës, por ky proces nuk shkaktoi ndryshime të mëdha në hapësirën tonë ajrore me përjashtim të efekteve të rregulloreve të implementuara nga ana e njërive të kontrollit të fluturimeve të vendosura në veri nga shteti ynë, te të cilët kishte një rritje të ndjeshme të trafikut. Si rezultat i kësaj rritjeje të papritur, një pjesë nga këto njësi të kontrollit të trafikut ajror implementuan rregullime të cilat pjesërisht ndikuan mbi rregullimin e trafikut tonë dhe shfaqjen e pikut pas heqjes së tyre.

Trafiku në aeroportet e Shkupit dhe Ohrit në vitin 2020 ka shënuar një rënie drastike krahasuar me vitin 2019, por gjithashtu ka manifestuar rritje konstante në 2 vitet e fundit. Në tabelën 1.5 më poshtë është prezantuar evolucioni i trafikut në aeroportet për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2022.

**Tabela 1.5: Numri i përgjithshëm i ngritjeve dhe i atertimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës së viteve 2013 - 2022<sup>5</sup>**


<sup>4</sup> Burimi: Shkup FMP.

<sup>5</sup> Burimi: Shkup FMP.



Vëllimi i trafikut në aeroportet e Shkupit dhe Ohrit sipas muajve, është prezantuar më poshtë në tabelën 1.6, dhe tregon një rritje të trafikut në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, por akoma është nën nivelin e vitit referues 2019.

**Tabela 1.6: Numri i përgjithshëm i ngritjeve dhe i atertimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë periudhës së viteve 2019 – 2022 sipas muajve<sup>6</sup>**



Edhe përkaj rritjes së konsiderueshme të volumit të trafikut prej 4% (5,5% overflights – fluturime transitore) krahasuar me vitin referues 2019, kushteve të pafavorshme të motit dhe kufizimeve për shkak të realizimit të projektit për zbatimin e sistemit të ri VHF, sezoni veror u përmbyll me sukses nga çdo aspekt, në radhë të parë nga pikëpamja e sigurisë, por edhe nga aspekti i ekspeditivitetit dhe efikasitetit.

Sipas statistikave të Byrosë qendrore të pagesave të “Eurocontrol” për vitin 2022, Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 2022 ka shënuar rritje të numrit të njësisive të faturimit nga fluturimet transitore për 52,2% në krahasim me vitin 2021, përkatësisht për 6,1% më shumë njësi të realizuara pagesore në krahasim me vitin 2019 si viti referues, përkatësisht në vitin para krizës pandemike.

<sup>6</sup> Burimi: Shkup FMP.

Charge area :	<b>LW</b>
---------------	-----------

Month	2022 Actual	2022 Unit Rate Basis	2021 Actual	2020 Actual	2019 Actual	% 2022 A / 2022 F	% 2022 A / 2019 A	% 2021 A / 2019 A
	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(1)/(2)	(1)/(5)	(3)/(5)
1 January	<b>17,786</b>	14,436	8,338	22,672	17,708	23.2%	0.4%	-52.9%
2 February	<b>15,376</b>	13,564	6,852	20,493	16,639	13.4%	-7.6%	-58.8%
3 March	<b>23,176</b>	15,679	9,087	14,355	19,233	47.8%	20.5%	-52.8%
4 April	<b>32,321</b>	23,174	9,845	3,678	28,427	39.5%	13.7%	-65.4%
5 May	<b>43,206</b>	32,979	12,454	4,181	40,456	31.0%	6.8%	-69.2%
6 June	<b>49,050</b>	37,480	21,943	5,417	45,978	30.9%	6.7%	-52.3%
7 July	<b>52,991</b>	41,208	38,450	17,682	50,551	28.6%	4.8%	-23.9%
8 August	<b>50,553</b>	41,263	45,991	25,368	50,618	22.5%	-0.1%	-9.1%
9 September	<b>45,428</b>	36,960	40,390	21,879	45,339	22.9%	0.2%	-10.9%
10 October	<b>42,792</b>	30,957	40,568	19,010	37,975	38.2%	12.7%	6.8%
11 November	<b>23,320</b>	16,798	21,639	9,596	20,607	38.8%	13.2%	5.0%
12 December	<b>23,096</b>	17,502	19,771	9,849	21,469	32.0%	7.6%	-7.9%
<b>TOTAL</b>	<b>419,094</b>	<b>322,000</b>	275,328	174,181	395,000	<b>30.2%</b>	<b>6.1%</b>	-30.3%

Dy aeroportet maqedonase, ai i Shkupit dhe i Ohrit, vitin 2022 e përfunduan me 2.371.423 pasagjerë, që paraqet një rritje prej 70,4% krahasuar me vitin 2021 dhe 19.448 operime të realizuara në dy aeroportet ose një rritje prej 29,8% në bazë vjetore. Sipas statistikave<sup>7</sup>, destinacioni më i frekuentuar nga aeroporti i Shkupit është Stambolli me 13.1% të pjesëmarrjes së tregut, më pas vijon Bazeli (Mulhouse) me 6.3%, Vjena me 6.2%, Cyrihu me 6.2% dhe Antalia me 4.2%, ndërsa destinacioni më i frekuentuar nga aeroporti i Ohrit është Vjena me 18% të pjesëmarrjes së tregut, Bazeli (Mulhouse) me 15.9% të pjesëmarrjes së tregut, më pas vijojnë Cyrihu me 11% dhe Memmingen me 10%.

Për nga aspekti i pjesëmarrjes së kompanive ajrore në trafikun e pasagjerëve, Wizz Air ka transportuar numrin më të madh të pasagjerëve me 59,3% të pjesëmarrjes së tregut, më pas pasojnë Turkish Airlines me 11%, Pegasus Airlines me 6,7%, Austrian Airlines me 6,2% dhe Chair Airlines me 4,9%, ndërsa për aeroportin e Ohrit - Wizz Air ka transportuar numrin më të madh të pasagjerëve me 69,31% të pjesëmarrjes së tregut, më pas vijon Chair Airlines me 8,76% dhe Tuifly Netherlands me 8,17%.

Për momentin e aktual, në suaza të rjetit të linjave të Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit janë paralajmëruar 52 destinacione për sezonin veror dhe 21 kompani ajrore të rregullta i shërbejnë këto linja.

Aeroporti i Ohrit - Shën Apostulli Pali posedon 8 destinacione të rregullta gjatë gjithë vitit, 9 destinacione të rregullta vetëm në sezonin e verës dhe 5 destinacione shtesë sezonale charter gjatë verës. Linjat e reja ajrore sezonale nga Ohri që janë paralajmëruar të prezantohen gjatë vitit 2023 janë Lot Polish Airlines (LODZ), Air Serbia – Beograd, TUI Fly – UK GATWICK dhe TUI Fly – UK MANCHESTER.


## **2 Analiza e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara të “M-NAV“ SH.A. – Shkup për vitin 2022**

<sup>7</sup> Burimi: Statistika e komunikacionit të pasagjerëve në suazat e TAV Maqedonia për vitin 2022.

## 2.1 Analiza e të hyrave të planifikuara dhe të realizuara të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022

S iç mund të vërehet nga tabela 2.1. e prezantuar më poshtë, gjatë vitit 2022 “M-NAV” SH.A. – Shkup manifeston zmadhimin e të hyrave të përgjithshme të realizuara krahas të hyrave të përgjithshme të planifikuara gjatë periudhës raportuese për 28,13% me sa vijon:

- 29,71% zmadhime të të hyrave nga fluturimet transitore;
- 16,50% zmadhime të të hyrave nga shërbimet terminale të navigacionit ajror, dhe
- 28,71% zmadhime të të hyrave të tjera.



Gjendja e trafikut në vitin 2022 gjerësisht është shpjeguar në Pikën 1 – Analiza e trafikut ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut si pjesë përbërëse e Raportit vjetor për punën e “M-NAV” SH.A. - Shkup për vitin 2022.

**Tabela 2.1: Të hyrat e planifikuara dhe të realizuara të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022<sup>8</sup>**


<i>Lloji i të hyrave</i>	<i>Të hyrat e planifikuara për vitin 2022</i>	<i>Të hyrat e realizuara për vitin 2022</i>	<i>Indeksi</i>

<sup>8</sup> Burimi: Plani financiar për ndryshim të Planit vjetor financiar të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022; Bruto – binancet e “M-NAV” SH.A. – Shkup për periudhën 01.01-31.12.2022 (përfundimisht me datën 08.03.2023).



<b>Fluturimet transitore të aeroplanëve</b>	887.175.083,40	1.150.792.035,34	129,71
<b>Shërbime terminale</b>	121.102.143,58	141.078.746,37	116,50
<b>Të hyra të tjera</b>	12.000.000,00	15.445.469,93	128,71
<b>Gjithsej të hyra (MKD):</b>	<b>1.020.277.226,98</b>	<b>1.307.316.251,64</b>	<b>128,13</b>

**2.1.1 Prezantimi grafik i të hyrave të planifikuara dhe të realizuara të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022**



**2.2 Analiza e shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022**


**Tabela 2.2: Shpenzime të planifikuara dhe të realizuara të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022<sup>9</sup>**

	<b>Shpenzime të</b>	<b>Shpenzime të</b>	
--	---------------------	---------------------	--

<sup>9</sup> Burimi: Plani financiar për ndryshim të Planit vjetor financiar të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022; Bruto – binancet e “M-NAV” SH.A. – Shkup për periudhën 01.01-31.12.2022 (përfundimisht me datën 08.03.2023).

<i>Lloji i shpenzimeve</i>	<i>planifikuara për vitin 2022</i>	<i>realizuara për vitin 2022</i>	<i>Indeksi</i>
<b><i>Gjithsej shpenzime për të punësuarit</i></b>	<b>759.776.868,00</b>	<b>972.284.269,08</b>	<b>127,97</b>
Pagat bruto	754.776.868,00	960.288.599,00	127,23
Shpenzime të tjera për të punësuarit	5.000.000,00	11.995.670,08	239,91
<b><i>Gjithsej shpenzime materiale</i></b>	<b>75.000.000,00</b>	<b>72.660.554,90</b>	<b>96,88</b>
Shpenzime për lëndët e para dhe për materialet	4.000.000,00	2.312.517,57	57,81
Shpenzimet për pjesët rezerve	14.000.000,00	1.154.160,97	8,24
Energjia e shpenzuar	18.000.000,00	35.764.374,20	198,69
Shërbimet transportuese	4.000.000,00	1.187.027,36	29,68
Shërbimet postare, shërbime të telefonisë dhe internetit	17.000.000,00	15.739.009,74	92,58
Shpenzimet për mirëmbajtje	16.000.000,00	14.022.888,56	87,64
Shpenzimet e përcaktuara në mënyrë plotësuese nga vitet e kaluara	2.000.000,00	2.480.576,50	124,03
<b><i>Gjithsej shpenzime jo materiale</i></b>	<b>83.475.000,00</b>	<b>53.694.047,82</b>	<b>64,32</b>
Qiraja për hapësirat e zyrave	1.500.000,00	0,00	0,00
Shërbime të tjera	850.000,00	736.522,00	86,65
Mëditjet për udhëzime zyrtare dhe shpenzimet rrugore	17.000.000,00	11.056.830,87	65,04
Shpenzimet për prezantime	2.550.000,00	2.872.123,54	112,63
Premitë për sigurime	12.000.000,00	13.300.140,00	110,83
Anëtarësitë në organizatat ndërkombëtare dhe të tjera	1.625.200,00	1.780.899,20	109,59
Shpenzimet tjera jo materiale	47.950.000,00	23.947.532,21	49,94
<b><i>Amortizimi</i></b>	<b>45.000.000,00</b>	<b>35.106.330,76</b>	<b>78,01</b>
<b><i>Shpenzimet tjera nga funksionimi</i></b>	<b>6.000.000,00</b>	<b>12.013.210,54</b>	<b>200,22</b>
<b><i>Gjithsej shpenzime financiare</i></b>	<b>13.000.000,00</b>	<b>24.600.924,55</b>	<b>189,24</b>
Shpenzimet bankare	3.000.000,00	13.476.765,07	449,23
Normat e interesit sipas kredive bankare	10.000.000,00	11.124.159,48	111,24
<b><i>Gjithsej shpenzime (MKD):</i></b>	<b>982.251.868,00</b>	<b>1.170.359.337,65</b>	<b>119,15</b>

**3.2.1 Prezantimi grafik i shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara të "M-NAV" SH.A. – Shkup për vitin 2022**



**S** iç mund të vërehet nga tabela 2.2. e prezantuar më lartë, në vitin 2022 "M-NAV" SH.A. - Shkup shënon realizim më të lartë të shpenzimeve të përgjithshme në raport me shpenzimet e përgjithshme të planifikuara për periudhën raportuese për 19,15%, gjatë kësaj:

- Zëri – pagat bruto për të punësuarit, janë realizuar më shumë mjete krahas mjeteve të planifikuara për 27,23% për më shumë shkaqe, me sa vijon:
  - Vendimi i miratuar nga ana e Këshillit drejtues të "M-NAV" SH.A. - Shkup me numër 02-500/4 të datës 15.04.2022, i cili përcakton dinamikën e kthimit të mjeteve të ndaluara nga pagat e punëtorëve për vitet 2020, 2021 dhe 2022 në përputhje me marrëveshjen e arritur me SSKL. Vendimi është miratuar si rezultat i rritjes së trafikut në hapësirën ajrore të RMV-së i cili ka tejkaluar parashikimet e planifikuara, projektimet e rrjedhjes së mjeteve financiare të gatshme të Shoqërisë dhe raportet dhe informacionet e Eurocontrol-it për përmirësimin e trafikut, si dhe funksionimi nikoqir dhe minimizimi i të gjitha shpenzimeve të Shoqërisë përmes një politike të kursimeve dhe efikasitetit maksimal gjatë zbatimit të synimeve të vendosura deri në stabilizimin e plotë financiar<sup>10</sup>;
  - shpenzimet e zmadhuara dhe të planifikuara për pagat bruto për transformimin e marrëdhënies së punës për 11 kontrollorët e trafikut ajror nga angazhimi në kohë të caktuar në angazhim pune në kohë të pacaktuar duke filluar nga data 01.01.2022, si dhe
  - realizimi i 15 punësimeve të reja, në pajtim me Planin financiar të Shoqërisë për vitin 2022<sup>11</sup>.
- Zëri – shpenzime tjera për të punësuarit, janë realizuar më shumë mjete se sa ishte planifikuar për shkak të pagesës së shpenzimeve në bazë të dispozitave të Marrëveshjes kolektive: ndihmë për vdekjen e një anëtar i të familjes, ndihmë për të punësuarit, shpërblime jubilarë, K-15, ekzaminime të detyrueshme mjekësore, shpenzime për provimet, kompensim për jetën e ndarë si dhe kompensime të tjera për punonjësit;

<sup>10</sup> Përfundimisht me datën 31.12.2022 në tërësi janë kthyer mjetet e ndaluara nga pagat e të punësuarve për vitin 2020, si dhe për periudhën e muajve janar – qershor të vitit 2021.

<sup>11</sup> Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2022 janë pensionuar 14 punëtorë, në pajtim me ndryshimin e fundit të nenit 104 të Ligjit për marrëdhënie pune (të shpallur në "Gazetën zyrtare të RMV-së" numër 151/2021), kurse për 1 të punësuar u realizua anulim i kontraktuar i Kontratës për punësim.

- Zëri – energji e shpenzuar, janë realizuar më shumë mjete se sa ishte planifikuar si rezultat i rritjes së shumëfishtë të çmimit të energjisë elektrike në vitin 2022;
- Zëri – shpenzimet e përcaktuara në mënyrë plotësuese nga vitet e kaluara, janë realizuar më shumë mjete se sa ishin planifikuar për shkak të shpenzimeve të realizuara në vitin 2021, dhe të njëjtat kanë ardhur dhe janë regjistruar në vitin 2022<sup>12</sup>;
- Zëri – shpenzimet për prezantim, janë realizuar më shumë mjete se sa janë planifikuar, në pjesën më të madhe për shpenzimet e shërbimeve që lidhen me mbledhjet afariste lidhur me aktivitetet dhe projektet investuese;
- Zëri – premitë për sigurim, janë realizuar më shumë mjete se sa ishte planifikuar si rezultat i nën zërit - premi për sigurim të anëtarëve të Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës të "M-NAV" SH.A. – Shkup për vitin 2022 në shumën prej 999.953,00 denarë<sup>13</sup>;
- Zëri – anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, gjithashtu manifeston zmadhime për nga aspekti i pikëve të vlerësimit, por rritja e vlerës është minimale në krahasim me planifikimet;
- Zëri - shpenzime të tjera nga funksionimi, janë realizuar më shumë mjete se sa ishte planifikuar për shkak të shpenzimeve për harmonizim vlerësorë<sup>14</sup>, si dhe shpenzimet në bazë të çregjistrimit të drejtpërdrejtë të kërkesave në shumën prej 902.367,48 denarë<sup>15</sup>;
- Zëri – shpenzimet e përgjithshme financiare, janë realizuar më shumë mjete krahas mjeteve të planifikuara për disa shkaqe, me sa vijon:
  - Shpenzimet e zmadhuara për provizione për shërbimet bankare në vend në shumën prej 2.527.557,00 denarë;
  - Nën zëri për provizionin e njëfishtë të paguar për kredinë nga BERZH në shumën prej 7.510.076,87 denarë<sup>16</sup>;
  - Zmadhimit të dallimeve negative të kurseve në shumën prej 3.388.319,25 denarë, dhe
  - Pagesa e normës së interesit për pagesë të vonuar të kontributeve për vitin 2020 në shumën prej 3.130.252,00 denarë<sup>17</sup>.
- Amortizimi është llogaritur në pajtim me politikën e kontabilitetit të "M-NAV" SH.A. – Shkup në pajtim me Standardet ndërkombëtare për njoftime financiare (SNNJF).

Duke pasur parasysh faktin se për pjesën më të madhe të zërave për shpenzimet e realizuara nuk ka devijime në raport me shpenzimet e planifikuara për vitin 2022 (me përjashtim të zërave të lartpërmendur, të cilët janë rezultat i rrethanave që nuk mund të parashikoheshin në procesin e planifikimit), mund të arrihet në konkluzionin se shpenzimet që janë rritur për periudhën nuk ndikojnë në

<sup>12</sup> U realizua pagesa e faturave për energji elektrike nga Ministria e mbrojtjes për muajin dhjetor të vitit 2021 në vlerë prej 2.202.417,00 denarë, 71.037,00 denarë për faturën e internetit, 53.100,00 denarë për faturën për dosje e dokumenteve dhe shpenzime tjera me shumë më të vogël).

<sup>13</sup> Në pajtim me Kontratën me "Kroacija Osiguruvanje" për furnizim public të shërbimeve – Sigurime jetësore – numër 02-665/3 e datës 01.07.2022.

<sup>14</sup> Harmonizimi vlerësorë në baza të ndryshme: zhvlerësimi i mjeteve themelore në shumën prej 218,488,95 denarë; harmonizimi vlerësorë i kërkesave në shumën prej 8.878.565,61 denarë; korrigjimi i vlerës së kërkesave – kërkesa të dyshimta dhe i kërkesave në shumën prej 6.195.584,61 denarë dhe çregjistrimi i kërkesave në bazë të TVSH-së në shumën prej 2.682.981,00 denarë.

<sup>15</sup> Në bazë të Vendimit të Qeverisë së RMV-së (të shpallur në "Gazetën zyrtare të RMV-së numër 41-10547/4 të datës 23.11.2022) për dhënien e pëlqimit për caktimin e detyrës së re për Eurocontrol për krijimin e fondeve vullnetare të solidaritetit për të mbështetur një ose më shumë vende anëtare në situata krize në trafikun ajror, si dhe krijimi i Fondit evropian ATM të solidaritetit vullnetar për të mbështetur Ukrainën dhe Moldavinë dhe fondin e përkohshëm të solidaritetit vullnetar për të mbështetur Estoninë, Letoninë, Lituaninë dhe Poloninë.

<sup>16</sup> Kompensimi I njëfishtë në shumën prej 1,25% nga shuma e huasë me BERZH (OPR.nr.53184) ose 122.125,00 euro.

<sup>17</sup> Në bazë të pagesës shtesë për pagat e ndaluara për punonjësit për vitin 2020.


realizimin e zërave të planifikuar në mënyrë të rregullt. Kjo do të thotë se efektet e devijimeve të shfaqura të këto zëra nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në arritjen e qëllimeve të planit financiar të Shoqërisë për vitin 2022, për këtë arsye Këshilli drejtues nuk merr masa plotësuese për ri përcaktimin e fondeve në suaza të planit të njëjtë financiar, përkatësisht prolongimi i realizimit të një qëllimi të caktuar ose eventualisht sigurimin e burimeve shtesë të financimit.

### 3 Analiza e të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara nga “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 krahas vitit 2021

#### 3.1 Analiza e të hyrave të realizuara nga “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 krahas vitit 2021

**S** lç mund të vërehet nga Tabela 3.1 e prezantuar më poshtë, të hyrat e përgjithshme të realizuara për vitin 2022 krahas vitit 2021 manifestojnë zmadhime për 57,47% me sa vijon:

- 61,57% zmadhime të të hyrat nga fluturimet transitore;
- 40,43% zmadhime të të hyrat nga shërbimet terminale të navigacionit ajror dhe
- 11,75% zvogëlime të të hyrat tjera.




**Tabela 3.1: Të hyrat e realizuara nga “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 krahas vitit 2021<sup>18</sup>**

<i>Lloji i të hyrave</i>	<i>Të hyra të realizuara Për vitin 2022</i>	<i>Të hyra të realizuara Për vitin 2021</i>	<i>Indeksi</i>
<i>Fluturime transitore nga aeroplanët</i>	1.150.792.035,34	712.253.661,31	161,57

<sup>18</sup> Burimi: Bruto – bilancet e “M-NAV” SH.A. – Shkup për periudhën 01.01-31.12.2022 (përfundimisht me datën 08.03.2023); Raporti vjetor për punën e „M-NAV“ SH.A. – Shkup për viti 2021.

<b>Shërbime terminale</b>	141.078.746,37	100.460.679,12	140,43
<b>Të hyra të tjera</b>	15.445.469,93	17.501.784,68	88,25
<b>Gjithsej të hyra (MKD):</b>	<b>1.307.316.251,64</b>	<b>830.216.125,11</b>	<b>157,47</b>

### 3.1.1 Prezantimi grafik i të hyrave të realizuara nga “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 krahas vitit 2021



### 3.2 Analiza e shpenzimeve të realizuara nga “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 krahas vitit 2021


Tabela 3.2: Shpenzime të realizuara nga “M-NAV” SH.A.- Shkup për vitin 2022 krahas vitit 2021<sup>19</sup>

Lloji i shpenzimeve	Shpenzime të realizuara për vitin 2022	Shpenzime të realizuara për vitin 2021	Indeksi
<b>Gjithsej shpenzime për të punësuarit</b>	<b>972.284.269,08</b>	<b>651.604.200,12</b>	<b>149,21</b>

<sup>19</sup> Burimi: Bruto – bilancet e “M-NAV” SH.A. – Shkup për periudhën 01.01-31.12.2022 (përfundimisht me datën 08.03.2023); Raporti vjetor për punën e “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2021.

Pagat bruto	960.288.599,00	640.397.276,00	149,95
Shpenzime të tjera për të punësuarit	11.995.670,08	11.206.924,12	107,04
<b>Gjithsej shpenzime materiale</b>	<b>72.660.554,90</b>	<b>50.213.602,46</b>	<b>144,70</b>
Shpenzime për lëndët e para dhe për materialet	2.312.517,57	2.435.861,95	94,94
Shpenzimet për pjesët rezerve	1.154.160,97	1.320.197,87	87,42
Energjia e shpenzuar	35.764.374,20	14.383.424,77	248,65
Shërbimet transportuese	1.187.027,36	877.625,17	135,25
Shërbimet postare, shërbime të telefonisë dhe internetit	15.739.009,74	16.455.689,55	95,64
Shpenzimet për mirëmbajtje	14.022.888,56	10.323.483,39	135,83
Shpenzimet e përcaktuara në mënyrë plotësuese nga vitet e kaluara	2.480.576,50	4.417.319,67	56,16
<b>Gjithsej shpenzime jo materiale</b>	<b>53.694.047,82</b>	<b>39.445.848,55</b>	<b>136,12</b>
Qiraja për hapësirat e zyrave	0,00	65.063,00	0,00
Shërbime të tjera	736.522,00	423.386,00	173,96
Mëditjet për udhëzime zyrtare dhe shpenzimet rrugore	11.056.830,87	2.703.197,75	409,03
Shpenzimet për prezantime	2.872.123,54	1.640.179,14	175,11
Premitë për sigurime	13.300.140,00	11.149.163,00	119,29
Anëtarësitë në organizatat ndërkombëtare dhe të tjera	1.780.899,20	1.742.948,61	102,18
Shpenzimet tjera jo materiale	23.947.532,21	21.721.911,05	110,25
<b>Amortizimi</b>	<b>35.106.330,76</b>	<b>35.841.840,82</b>	<b>97,95</b>
<b>Shpenzimet tjera nga funksionimi</b>	<b>12.013.210,54</b>	<b>4.236.931,44</b>	<b>283,54</b>
<b>Gjithsej shpenzime financiare</b>	<b>24.600.924,55</b>	<b>11.420.369,87</b>	<b>215,41</b>
Shpenzimet bankare	13.476.765,07	2.537.483,74	531,11
Normat e interesit sipas kredive bankare	11.124.159,48	8.882.886,13	125,23
<b>Gjithsej shpenzime (MKD):</b>	<b>1.170.359.337,65</b>	<b>792.762.793,26</b>	<b>147,63</b>

**3.2.1 Prezantimi grafik i shpenzimeve të realizuara nga “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 krahas vitit 2021**



**S** iç mund të vërehet nga tabela 3.2. e prezantuar më lartë, shpenzimet

e përgjithshme të realizuara nga ana e Shoqërisë për vitin 2022 manifestojnë zmadhime për 47.63 % krahas vitit 2021, si rezultat i:

- Zëri – pagat bruto për të punësuarit manifestojnë zmadhime krahas vitit 2021 për 49,95% për disa shkaqe:
  - Vendimi i miratuar nga ana e Këshillit drejtues të "M-NAV" SH.A. - Shkup me numër 02-500/4 të datës 15.04.2022, i cili përcakton dinamikën e kthimit të mjeteve të ndaluara nga pagat e punëtorëve për vitet 2020, 2021 dhe 2022 në përputhje me marrëveshjen e arritur me SSKL. Vendimi është miratuar si rezultat i rritjes së trafikut në hapësirën ajrore të RMV-së i cili ka tejkaluar parashikimet e planifikuara, projektimet e rrjedhjes së mjeteve financiare të gatshme të Shoqërisë dhe raportet dhe informacionet e Eurocontrol-it për përmirësimin e trafikut, si dhe funksionimi nikoqir dhe minimizimi i të gjitha shpenzimeve të Shoqërisë përmes një politike të kursimeve dhe efikasitetit maksimal gjatë zbatimit të synimeve të vendosura deri në stabilizimin e plotë financiar<sup>20</sup>;
  - shpenzimet e zmadhuara dhe të planifikuara për pagat bruto për transformimin e marrëdhënies së punës për 11 kontrollorët e trafikut ajror nga angazhimi në kohë të caktuar në angazhim pune në kohë të pacaktuar duke filluar nga data 01.01.2022, si dhe
  - realizimi i 15 punësimeve të reja, në pajtim me Planin financiar të Shoqërisë për vitin 2022<sup>21</sup>, prej tyre 7 (shtatë) në kohë të pa caktuar, dhe 8 (tetë) persona/studentë themeluan marrëdhënie pune në kohë të caktuar.
- Zëri – shpenzime tjera për të punësuarit<sup>22</sup>, manifestojnë zmadhime krahas vitit 2021 për 7,04% dhe në mënyrë të detajuar janë prezantuar më poshtë:

<sup>20</sup> Përfundimisht me datën 31.12.2022 në tërësi janë kthyer mjetet e ndaluara nga pagat e të punësuarve për vitin 2020, si dhe për periudhën e muajve janar – qershor të vitit 2021.

<sup>21</sup> Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2022 janë pensionuar 14 punëtorë, në pajtim me ndryshimin e fundit të nenit 104 të Ligjit për marrëdhënie pune (të shpallur në "Gazetën zyrtare të RMV-së" numër 151/2021), kurse për 1 të punësuar u realizua anulim i kontraktuar i Kontratës për punësim.



**Tabela 3.3: Shpenzime të tjera të realizuara për të punësuarit në “M-NAV” SHA.A. – Shkup për vitin 2022 krahas vitit 2021<sup>23</sup>**

<b>Shpenzimet tjera për të punësuarit</b>	<b>01.01-31.12.2022</b>	<b>01.01-31.12.2021</b>
Çmime jubilarë	2.192.679,00	3.277.204,00
Ndihma për raste të vdekjes së anëtarit të familjes	780.414,00	2.752.642,00
Ndihma për të punësuarit	872.648,00	714.016,00
Pagesa e K -15	6.434.443,00	2.990.000,00
Kompensimi për jetë të ndarë	0,00	49.320,00
Kontrollime të detyrueshme mjekësore për kontrollorët	898.211,08	1.282.394,12
Shpenzimet për provimet	597.581,00	92.778,00
Kompensimet tjera për të punësuarit	219.694,00	48.570,00
<b>Gjithsej (MKD):</b>	<b>11.995.670,08</b>	<b>11.206.924,12</b>

- Zëri – shpenzimet për energjisë në vitin 2022 janë rritur në krahasim me vitin 2021, kryesisht për shkak të rritjes së shumëfishtë të çmimit të energjisë elektrike në vitin 2022, si dhe nën zërit për vaj ekstra të lehtë të shpenzuar për ngrohje dhe naftë dizel dhe benzinë për makinat zyrtare, edhe për të njëjtat lëndë u zmadhuan çmimet në vitin 2022;
- Zëri – shpenzimet për shërbimet e transportit në vitin 2022 janë rritur në krahasim me vitin 2021 për shkak të nën zërave për transportin me taksì dhe shërbime të tjera transportuese, por të njëjtit sillen në suaza të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2022;
- Zëri - shpenzimet për mirëmbajtje në vitin 2022 manifestojnë rritje në krahasim me vitin 2021 për shkak të nën zërit për mirëmbajtje rrjedhëse të pajisjeve në shumën prej 9.443.995,56 denarë, nën zëri - mirëmbajtja e higjienës në shumën prej 2.785.948,00 denarë, si dhe nën zëri për mbrojtje dhe avancim të ambientit të punës dhe mjedisit jetësorë dhe shërbimet për mirëmbajtjen e gjelbërimit në shumë të përgjithshme prej 566.189,00 denarë, por të njëjtit janë në suaza të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2022;
- Zëri – shpenzimet tjera gjatë vitit 2022 manifestojnë zmadhime krahas shpenzimeve të gjeneruara gjatë vitit 2021, me sa vijon:

**Tabela 3.4: Shërbime të tjera të realizuara nga “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021<sup>24</sup>**

<b>Shërbime të tjera</b>	<b>01.01-31.12.2022</b>	<b>01.01-31.12.2021</b>
Regjistrimi i automjeteve	96.456,00	91.898,00

<sup>22</sup> Në këtë zë bëjnë pjesë shpenzimet që paguhen në pajtim me Marrëveshjen kolektive të “M-NAV” SH.A. – Shkup.

<sup>23</sup> Burimi: Bruto – bilancet e “M-NAV” SH.A. – Shkup për periudhën 01.01-31.12.2022 (përfundimisht me datën 08.03.2023); Raporti vjetor për punën e “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2021.

<sup>24</sup> Burimi: Bruto – bilancet e “M-NAV” SH.A. – Shkup për periudhën 01.01-31.12.2022 (përfundimisht me datën 08.03.2023); Raporti vjetor për punën e “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2021.

Shpallje në gazetata zyrtare	603.828,00	331.488,00
Shërbimet për deratizim	36.238,00	0,00
<b>Gjithsej (MKD):</b>	<b>736.522,00</b>	<b>423.386,00</b>

- Zëri – mëditjet për udhëtime pune dhe shpenzimet e udhëtimit, manifeston rritje në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, në pjesën më të madhe për shpenzimet për bujtje dhe për mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit, si rezultat i intensifikimit të aktiviteteve investuese, por të njëjtit sillen brenda shpenzimeve të planifikuara për vitin 2022. Si rezultat i të gjitha kufizimeve lidhur me udhëtimet që u miratuan në vitin 2021, për shkak të pandemisë Covid-19, udhëtimet zyrtare jashtë vendit u sollën në minimum;
- Zëri – shpenzimet për përfaqësim në vitin 2022 janë rritur në krahasim me ato të vitit 2021, në pjesën më të madhe për shkak të shpenzimeve për shërbimet që lidhen me takimet afariste rreth aktiviteteve dhe projekteve investuese;
- Zëri – premitë për sigurime në vitin 2022 janë rritur në krahasim me ato të vitit 2021, në pjesën më të madhe për shkak të nën zërit për premit e sigurimit për anëtarët e Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës të "M-NAV" SH.A. – Shkup për vitin 2022 në shumën prej 999.953,00 denarë <sup>25</sup>;
- Zëri - anëtarësimet në organizatat ndërkombëtare në vitin 2022 janë rritur në krahasim me ato të vitit 2021, por rritja është minimale për nga aspekti i pikëve të përqindjes dhe nuk ka implikime vlerësore financiare për Shoqërinë;
- Zëri – shpenzimet tjera jo materiale gjatë vitit 2022 manifestojnë zmadhime krahas shpenzimeve të vitit 2021, me sa vijon:

**Tabela 3.5: Shpenzime të tjera jo materiale të realizuara nga “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 krahas vitit 2021 <sup>26</sup>**

Shpenzimet tjera jo materiale	01.01-31.12.2022	01.01-31.12.2021
<b>Qiraja për patundshmëritë</b>	<b>1.568.797,00</b>	<b>65.063,00</b>
- Qiraja për antenën në Majën e zezë	64.091,00	65.063,00
- Qiraja për hapësirën afariste <sup>27</sup>	1.504.706,00	0,00

<sup>25</sup> Në pajtim me Kontratën me “Kroacija Osiguruvanje” për furnizimin publik të shërbimeve – Sigurime jetësore me numër 02-665/3 e datës 01.07.2022.

<sup>26</sup> Burimi: Bruto – bilancet e “M-NAV” SH.A. – Shkup për periudhën 01.01-31.12.2022 (përfundimisht me datën 08.03.2023); Raporti vjetor për punën e “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2021.

<sup>27</sup> Në pajtim me Kontratën me “TAV Makedonija” për huazim të hapësirës afariste në suaza të Aeroportit ndërkombëtarë Shkup, si dhe në pajtim me kontratën për huazim të hapësirës afariste – objekti “Mallaga” në Qendër, Shkup.

Kompensimi për këshillin mbikëqyrës	408.109,00	437.256,00
Honorarë autorial <sup>28</sup>	896.255,00	1.718.864,00
Shërbime konsultuese <sup>29</sup>	3.876.066,72	2.350.294,70
<b>Seminare dhe këshillime</b>	<b>1.580.325,24</b>	<b>302.670,00</b>
- OJTI refresh kursi për KL <sup>30</sup>	1.102.984,24	0,00
- Kurse të tjera dhe trajtime për të punësuarit	477.341,00	302.670,00
Revidimi i raporteve financiare <sup>31</sup>	600.000,00	600.000,00
Shërbimet për ekspertiza dhe vlerësime	0,00	9.000,00
Shërbime të avokatëve <sup>32</sup>	1.557.679,00	794.815,00
Mirëmbajtja e softuerit	90.024,00	83.068,00
<b>Shërbime të tjera intelektuale</b>	<b>2.404.021,90</b>	<b>4.163.290,70</b>
- Shpenzime për provizione të Eurocontrol <sup>33</sup>	924.675,00	923.923,50
- Shërbime brokere <sup>34</sup>	500.000,00	500.000,00
- Përpilimi i gjeo – hartave <sup>35</sup>	402.195,74	412.149,94
- Kompensimi vjetor nga CDHV <sup>36</sup>	146.358,00	128.299,00
- Përkthime të dokumenteve	93.500,00	32.750,00
- Përpilimi i dokumentacionit projektues dhe matjet e gjeodezisë <sup>37</sup>	110.000,00	60.000,00
- Kompensimi për mirëmbajtjen e bazës elektronike të të dhënave	110.960,00	35.306,00
- Përpilimi i elaboratit të gjeodezisë <sup>38</sup>	60.000,00	1.179.765,00
- Provizione për agjencitë <sup>39</sup>	29.703,00	0,00
- Përpilimi i dokumentacionit ndërtimor – teknik	14.160,00	0,00
- Përtëritja e certifikatat digjital		
- Kompensimi nga Bursa Maqedonase <sup>40</sup>	6.400,00	2.790,00
- Përtëritja e domeinit	4.130,00	4.130,00
- Trajnime	1.940,16	0,00
- Kompensimi vjetor për Arkivin shtetërorë	0,00	690.984,00
- Certifikimi sipas standardeve ISO	0,00	128.480,00
- Shërbime të komunikimit <sup>41</sup>	0,00	60.900,00
	0,00	3.813,26
Revista dhe gazeta profesionale <sup>42</sup>	120.505,00	127.576,00
Shpenzime për certifikime dhe licenca nga ACV	10.560.908,17	10.489.135,65
Shpenzime për aktgjykime përmbaruese	0,00	103.456,00
<b>Shpenzime të tjera jo materiale</b>	<b>284.841,18</b>	<b>542.485,00</b>
- Dhënia e vërtetimit për mos gjykim të punësuarve	3.133,00	179.265,00
- Arkivimi i dokumenteve <sup>43</sup>	160.152,00	163.122,00
- Përgatitja e kartelave të identifikimit <sup>44</sup>	27.174,00	146.474,00
- Shpenzime të tjera jo materiale <sup>45</sup>	94.382,18	53.624,00

<sup>28</sup> Në pajtim me Kontratën për vepër për 3 të punësuarit në vitin 2022, dhe për 5 të punësuar gjatë vitit 2021.

<sup>29</sup> Në pajtim me Kontratën për shërbime konsultuese me EGIS AVIA.

<sup>30</sup> Kurse të detyrueshme për kontrollorët e fluturimit për çdo 2 vite.

<sup>31</sup> Në pajtim me Kontratën për realizimin e revizionit të raporteve financiare për shtëpinë konsultuese Grand Tornton Shkup.

<sup>32</sup> Në pajtim me Kontratën me Avokatin Mefail Arslani, Avokatin Zekir Zekiri dhe Avokatin Albin Bexheti, kurse gjatë vitit 2021 u lidhën kontrata me Avokatin Mefail Arslani dhe Avokatin Zekir Zekiri.

<sup>33</sup> Në pajtim me Kontratën për realizimin e shërbimeve për pagesa të shërbimeve ATS nga ana e kompanive ajrore.

<sup>34</sup> Në pajtim me Kontratën me Brokerin për sigurime CN.

<sup>35</sup> Parapagesa vjetore për Hartografi Bentli.

<sup>36</sup> Parapagesa vjetore për udhëheqjen e aksioneve dhe kompensimi për regjistrim të rritjes së kryegjësë.

<sup>37</sup> Në pajtim me Kontratën me GEING SHPK Shkup për përpilim të dokumentacionit teknik – kyçje kabllorike në objektin e stacionit të radarit "Banjski Rid" në suaza të rrjetit distributiv të EVN Maqedonia.

<sup>38</sup> Përpilimi i elaboreve të gjeodezisë për azhurnim të bazamentit të gjeodezisë për përpilim të dokumentacionit lokal planifikues urbanistik (Aeroporti ndërkombëtarë - Shkup dhe Aeroporti Shën Apostulli Pali – Ohër) si dhe përpilimi i elaboratit të gjeodezisë për qëllime të veçanta.

<sup>39</sup> Pagesa për Agjencinë për patundshmëri NEW WAY Ltd. Për shërbim të realizuar – ndërmjetësim gjatë huazimit të hapësirës afariste në komunën Qendër për nevojat e Shoqërisë.

<sup>40</sup> Për publikimin e Raporteve financiare në tregun e lirë.

<sup>41</sup> Shërbime të komunikimit (MET OFFICE).

<sup>42</sup> "Reprezent", "Pravnik", "Akademik", "Koha", "Sllloboden pečat".

<sup>43</sup> Në pajtim me Kontratën me firmën - INBOX Shkup.

<sup>44</sup> Kartelat e identifikimit për qasjen e të punësuarve të "M-NAV" SH.A. – Shkup në pistën e aeroportit dhe deri te hapësirat e aeroportit, në pronësi të TAV Maqedonia.

<sup>45</sup> Shpenzime për fotokopjime të dokumenteve, përpilimi i vizit kartelave, dhënia e vizave për të punësuarit, parashtrimi i Llogarisë vjetore dhe etj.

<b>Gjithsej (MKD):</b>	<b>23.947.532,21</b>	<b>21.786.974,05</b>

## 4. Investimet dhe zhvillimi

**D**uke pasur parasysh kompleksitetin dhe rëndësinë e navigacionit ajror si dhe nevojën e integritit në sistemin e Qiellit të përbashkët evropian (Single European Sky) dhe kuptohet, harmonizimin me legjislacionin evropian dhe standardet e organizatave relevante përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare të navigacionit ajror, këshilli drejtues i "M-NAV" SH.A. – Shkup solli vendim për financimin e projekteve më të rëndësishme zhvillimore të përcaktuara në kuadër të "Projektit për sendërtimin e sistemit të navigacionit ajror të Maqedonisë - faza e dytë" me qëllim të financimit me kredi afatgjate nga institucioni financiar ndërkombëtar. Në koordinim me Ministrinë e financave dhe Ministrinë e transportit dhe lidhjeve, procedura për detyrim afatgjatë të "M-NAV" SH.A. - Shkup te një institucion financiar ndërkombëtar përfundoi në vitin 2013. Më datën 24.09.2013, "M-NAV" SH.A. – Shkup nënshkroi Kontratën për huamarrje me BERZH për financimin e "Projektit për sendërtimin e sistemit të navigacionit ajror të Maqedonisë - faza e dytë" pa sigurimin e garancisë shtetërore, në vlerë prej 11.150.000,00 euro, Kontrata u plotësua me amendamentin nr. 1 të lidhur më datën 10.01.2014, Amendamenti nr. 2 i lidhur më datën 13.12.2016 dhe Amendamenti nr.3 të lidhur më datën 27.02.2020.

Për mbylljen dhe ri financimin e kredisë aktuale, me kushte më të favorshme të kreditimi, për ti tejkaluar vështirësitë financiare të shkaktuara nga pandemia Covid-19 dhe për të vazhduar me realizimin e pa penguar të projekteve, "M-NAV" SH.A. – Shkup, gjatë vitit 2022, i ka finalizuar negociatat me BERZH, dhe pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datën 29.07.2022 nënshkroi marrëveshje të re të huamarrjes me BERZH (në shumën prej 10,000,000.00 euro), si dhe kontratën me "Komercijalna banka" SH.A. Shkup (me shumën prej 5.000.000,00 euro). Në të njëjtën kohë, "M-NAV" SH.A. – Shkup pranoi mjete në shumën prej 400.000,00 euro nga fondet për grandet e BERZH, të cilat janë të destinuara për shërbime konsulente në realizimin e projekteve dhe trajnimin e kontrollorëve për t'iu bashkuar SECSI FRA (South East Common Sky Initiative Free Route Airspace).

Karakteristika kryesore e vitit 2022 ishte rikuperimi i fuqishëm nga pasojat e pandemisë Covid-19, gjë që mundësoi rritjen e volumit të punës gjatë realizimit të komponentëve të projekteve.

### 4.1 Projekti për sendërtim të sistemit maqedonas për navigacion ajrorë – faza e dytë e financiar me mjetet e BERZH

Në vijim pason analiza e detajuar e realizimit të çdo komponenti projektues të përfshirë me "Projektin për sendërtim të sistemit maqedonas për navigacionin ajrorë – faza e dytë" gjatë vitit 2022.

#### 4.1.1 Furnizimi, instalimi dhe testimi i Sistemit ATM, duke përfshirë edhe sallën teknike - operative

Sistemi ATM është sistemi primar përmes të cilit realizohet shërbimi themelorë i "M-NAV" SH.A. - Shkup, gjegjësisht ofrimi i shërbimeve të navigacionit ajror në hapësirën ajrore mbi Republikën e Maqedonisë së Veriut me qëllim të zhvillimit të trafikut ajror të sigurt, të rregullt dhe efikas. Implementimi i sistemit të ri ATM përfshin edhe ndërtimin e një hapësire të re për nevojat e sistemit ATM, d.m.th. një sallë e re teknike dhe operative ku do të vendosen pajisjet nga sistemi i ri dhe i vjetër (rezervë) i ATM-së.

Në pajtim me Kontratën e huamarrjes me BERZH, është përcaktuar se ky komponent i projektit do të realizohet përmes metodës së prokurimit me dy faza (Two Stage Procurement Method). Pas zbatimit të plotë të dy fazave të prokurimit, më datën 31.07.2017 nga BERZH u aprovua lejimi (No objection - Pa kundërshtim) për Raportin e vlerësimit - faza e dytë, me rekomandim për lidhjen e Kontratës me firmën "Leonardo S.p.A.", oferta e së cilës në tërësi i plotësoi kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike dhe dokumentacionin e tenderit.

Nga ana tjetër, u konstatua se trualli në të cilin parashikohet të ndërtohet salla e re operative teknike (zgjerimi i objektit ekzistues), me një sipërfaqe totale prej 1.150 m<sup>2</sup>, nga e cila bazamenti është me sipërfaqe 580 m<sup>2</sup>, që paraqet pronë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe sipas Kontratës për koncesion, e njëjta i është caktuar për shfrytëzim dhe menaxhim Holdingut TAV – Aeroporte nga Turqia, për këtë arsye janë ndërmarrë aktivitete me institucionet përkatëse për të zgjidhur dhe tejkaluar situatën e përgjithshme pronësore juridike për sa i përket rregullimit të marrëdhënieve juridike pronësore dhe dokumentet e lejes së ndërtimit, si për sallën e re teknike të operimit ashtu edhe për objektin ekzistues të kontrollit të trafikut ajror.

Në pajtim me Konkluzionit nga Ekstrakti i Draft-procesverbalit të seancës së 96-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të mbajtur më datën 22.10.2018, Këshilli drejtues i "M-NAV" SH.A. – Shkup miratoi Vendimin me nr. 02-2017/8 të datës 31.10.2018, për t'i dërguar Letra për pranimin dhe Kontratën për furnizimin e sistemit ATM, duke përfshirë edhe sallën tekniko-operative për të njëjtin, deri te firma e ranguar si e para - Leonardo S.p.A, për nënshkrimin e kontratës në përputhje me lejen e dhënë (No objection - No objection - Pa kundërshtim) nga ana e BERZH më datën 31.07.2017. Nga ana e kompanisë - Leonardo S.p.A, është dorëzuar garancia e kërkuar për cilësinë e performancës së realizimit dhe Kontrata është nënshkruar më datën 14.12.2018 me çmimin e Kontratës në shumën prej 7.878.872,50 euro. Në fillim të vitit 2019, nga kompania Leonardo S.p.A. është dorëzuar garancia bankare për pagesë paraprake dhe fatura për pagesën paraprake, pas së cilës deri te BERZH është dorëzuar Aplikimi për tërheqjen e mjeteve. Pagesa e faturës për pagesë paraprake u realizua më datën 02.04.2019 dhe me këtë veprim Kontrata hyri në fuqi.

Realizimi i projektit filloi me prokurimin e pajisjeve (harduerin) nga ana e firmës Leonardo, përkatësisht me fillimin e procesit të instalimit, implementimit dhe integritit të nën tërësive funksionale. Megjithatë, gjatë viteve 2020 dhe 2021, projekti u realizua me dinamikë të reduktuar për shkak të thirrjes në parimin e "Forcës Madhore" nga ana e Leonardo S.p.A, si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19

Më datën 15.06.2021, pas marrjes së lejes nga BERZH, u nënshkrua Urdhri i Ndryshimit CO-X-001 (Change Order CO-X-001) me qëllim të azhurnimit të afatit kohor për zbatimin e kontratës. Në muajin nëntor të vitit 2021, pas marrjes së lejes nga EVBOR, u nënshkrua Urdhri i ndryshimit CO-X-003 (Change Order CO-X-003), dhe me këtë u azhurnua afati kohor për 159 ditë shtesë për të finalizuar trajnimin e personelit operacional dhe teknik të "M-NAV" SH.A. - Shkup. Dy vendimet nuk kishin implikime financiare.

Trajnimi i personelit filloi në muajin nëntor të vitit 2021 dhe përfundoi në tremujorin e dytë të vitit 2022, kur u realizua përshtatja përfundimtare e sistemit me nevojat e "M-NAV" SH.A. - Shkup. Gjatë muajve qershor dhe korrik të vitit 2022, me

sukses është kryer dhe përfunduar FAT (Factory Acceptance Test), me faktin se një numër i caktuar i vërejtjeve nga i njëjti janë paraparë dhe planifikuar për t'u korrigjuar me Planin e korrigjimit (Remedy Plan) gjatë vitit 2023.

Për sa i përket pjesës së projektit që i referohet performancës së realizimit të pjesës së ndërtimit, gjatë muajit dhjetor të vitit 2021, nga firma Leonardo është dorëzuar një ofertë financiare që rezulton nga diferencat midis Projektit ideor dhe Projektit themelor për ndërtimin e ndërtesës teknike - operative, si pjesë e Kontratës për prokurim të sistemit ATM. Si përgjigje, nga ana e "M-NAV" SH.A. - Shkup u dorëzua kërkesa deri te firma Leonardo për rishqyrtim dhe zbërthim të çmimit total të ofruar sipas zërave të ndarë në veçanti si dhe fillimi i menjëhershëm i aktiviteteve ndërtimore.

Të njëjtit kanë filluar më datën 22.01.2022, me këtë janë respektuar afatet ligjore për fillimin e ndërtimit. Në gjysmën e parë të vitit 2022 u paraqit një ofertë e re nga firma Leonardo, ofertë që i merr parasysh të gjitha diferencat në projekte, si dhe çmimet e reja të tregut. Oferta ishte e papranueshme për "M-NAV" SH.A. - Shkup, pas kësaj në muajin maj u mbajtën negociata në Romë, me qëllim të përcaktimit të shumës plotësuese të nevojshme për finalizimin e ndërtesës teknike - operative. Në bazë të këtij takimi është përgatitur Change Order CO-H-002 - Urdhri i Ndryshimit CO-H-002, për të cilin BERZH dha lejen përkatëse më datën 21.07.2022.

Me të njëjtin ishte paraparë zmadhimi prej 748.000,00 euro dhe kushte të reja të pagesës. Megjithatë, përkundër kushteve tashmë të dakorduara dhe dokumentit të nënshkruar nga "M-NAV" SH.A. - Shkup më datën 26.07.2022, ky dokument nuk u nënshkruar nga firma Leonardo, ndërsa në muajin nëntor të vitit 2022 deri te "M-NAV" SH.A. – Shkup është dorëzuar kërkesë zyrtare për pezullimin e Change Order CO-H-002 (Urdhrit për ndryshim CO-H-002), meqenëse për shkak të rritjes plotësuese të çmimeve në treg, as kushtet e reja nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e ndërtimit. Kjo është vlerësuar si veprim i papranueshëm nga "M-NAV" SH.A. – Shkup, për faktin se ndikon drejtpërdrejt në qëllimet strategjike të "M-NAV" SH.A. - Shkup, gjegjësisht në përpjekjet për përparim drejtë ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror. Në të njëjtën kohë, Këshilli drejtues i "M-NAV" SH.A. - Shkup mori vendim që lokacioni për instalimin e sistemit ATM të zhvendoset në një hapësirë tjetër në objektin ekzistues të "M-NAV" SH.A. - Shkup, hapësirë kjo e cila menjëherë filloi të rimodelohet me qëllim të instalimit pa pengesa dhe funksionimit të mëtejshëm të sistemit. Vendimi përfundimtar për aktivitetet e mëtejshme në lidhje me ndërtesën teknike-operative pritet në fillim të vitit 2023.

Realizimi i tërësishëm i komponentit projektues për sistemin ATM parashikohet që të përfundoj në muajin dhjetor të vitit 2023.

#### **4.1.2 Furnizimi, instalimi dhe testimi i radio sistemit VHF dhe i linkut të mikro valëve**

Ky është një sistem përmes të cilit kontrolli i trafikut ajror realizon radio komunikimin me aeroplanët. Sipas anekseve të ICAO-s, ofruesi i shërbimit të navigacionit ajror është i detyruar që të sigurojë një sistem të radiotelefonisë me aeroplanët, nëpërmjet një sistemi të radio komunikimit që funksionon në intervalin e frekuencave të përcaktuara ekskluzivisht për këtë qëllim. Ky projekt do të zëvendësojë radio pajisjet ekzistuese dhe sistemin bartës me një sistem të ri radio VHF.

Pas realizimit të procedurës së plotë të prokurimit, më datën 17.03.2017 nga BERZH është pranuar - No Objection (Pa kundërshtim) për Raportin e vlerësimit të ofertave të pranura me propozimin për lidhjen e Kontratës me firmën Northop

Grumman/Park Air Systems në shumën totale prej 778.054,56 euro, në të cilën shumë përfshihen edhe 53.140,58 euro për pjesët rezerve.

Pas dorëzimit të informacionit deri te ofertuesit tjerë për rezultatin e raportit të vlerësimit, dy firmat pjesëmarrëse në tender paraqesin ankesa për përzgjedhjen deri te BERZH. Nga ana e BERZH është dorëzuar miratimi (më datën 20.07.2018) për nënshkrimin e Kontratës, me këtë u refuzuan dy ankesat për përzgjedhjen e ofertuesit të renditur si ofertuesi i parë. Pas miratimit të Kontratës dhe Amendamentit nr. 1 nga ana e BERZH, të njëjtit u nënshkruan më datën 11.03.2019. Pagesa e faturës për pagesë paraprake në shumën prej 155.610,92 euro u realizua më datën 12.07.2019, me këtë veprim Kontrata hyri në fuqi. Projekti filloi me realizim në pajtim me planin e dorëzuar nga Park Air Systems me zbatimin e testimit fabrikues të pajisjeve (FAT) dhe të njërit nga trajnimet e planifikuara. Në pajtim me planin, sistemi duhej të dorëzohej në muajin gusht të vitit 2019, me implementim përfundimtar deri në fund të muajit tetorit të vitit 2019. Projekti filloi me vonesë gjatë dorëzimit të pajisjeve nga ana e Park Air dhe ishte e pamundur të përfundonte instalimi në "Sollunska Gllava" gjatë vitit 2019. Pas revidimit të planit të zbatimit, instalimi i sistemit në Aeroportin e Shkupit duhej të realizohet në vitin 2019, ndërsa instalimi dhe testimi në "Sollunska Gllava" gjatë vitit 2020. Për shkak të shfaqjes së pandemisë Covid-19 në vitin 2020, Park Air Systems u thirr në dispozitën e kontratës për – "Fuqinë madhore", vendim të cilin e pranoi Këshilli drejtues i "M-NAV" SH.A. – Shkup, me këtë përkohësisht u ngadalësua zbatimi i projektit, gjegjësisht Park Air Systems nuk i realizoi aktivitetet e planifikuara gjatë vitit 2020. Më datën 08.02.2021, pas miratimit nga ana e BERZH, u nënshkrua Amendamenti nr. 2 i Kontratës, me të cilin u prolongua afati i realizimit deri në muajin shtator të vitit 2021. Për shkak të problemeve lidhur me pajisjet e dorëzuara nga Park Air dhe kohën e nevojshme për servisimin e tyre, afati për përfundimin e procesit të instalimit u prolongua për tremujorin e dytë të vitit 2022.

Në vitin 2022 përfundoi trajnimi për personelin teknik, si dhe instalimi i sistemit në dy lokacionet, Aeroportin e Shkupit dhe në "Sollunska Gllava", gjatë kësaj u kompletua edhe testimi SAT (Site Acceptance Test), megjithatë për shkak të disa vërejtjeve të vogla, certifikata OAC (Operational Acceptance Certificate) do të jepet gjatë muajit qershor të vitit 2023 kur situata e motit në lokalitetin "Sollunska Gllava" do të lejojë që të vazhdojnë aktivitetet punuese, me këtë do të finalizohet ky komponent i projektit.

#### **4.1.3 Furnizimi, instalimi dhe testimi i sistemit për komunikim zanor (VCS)**

Në suaza të sistemit të kontrollimit të trafikut ajror, një nga nën sistemet themelore përmes të cilit realizohet komunikimi i kontrolluesit të trafikut ajror me aeroplanët, por edhe me qendrat fqinje të kontrollit të trafikut ajror, është sistemi për komutacion të kanaleve për bisedime zanore. Sistemi i ri do të zëvendësojë sistemin aktual, i cili tashmë është i vjetër 20 vite dhe do të bëhet sistem primar përmes të cilit do të zhvillohet komunikimi në suaza të kontrollit të trafikut ajror.

Procedura për furnizimin e një sistemi të ri VCS është realizuar tashmë në vitet 2017 dhe 2018, por për shkak të mosplotësimit të kërkesave teknike nga të gjithë ofertuesit, më datën 19.06.2018, është pranuar miratimi nga ana e BERZH për përsëritjen e prokurimit dhe shpalljen e prokurimit të ri (në dy faza) me revidim të specifikimit teknik.

Pas përgatitjes së dokumentacionit të plotë në formatin e përshtatshëm për e-portalin e prokurimeve të BERZH-it (ECEPP), procedura e tenderit filloi më datën 07.06.2021, me publikimin e Ftesës për dorëzimin e ofertave në ECEPP. Faza e dytë filloi më datën 21.01.2022 dhe zgjati deri më datën 04.03.2022 me hapjen e ofertave nga tre kompanitë që hynë në këtë fazë. Më pas pasoi vlerësimi përfundimtar i ofertave, pas së kësaj u dorëzua Letër për pranimin e Kontratës për furnizim të Sistemit VCS që iu dërgua kompanisë së renditur si e para nga ofertuesit - Rohde & Schwarz nga Austria. Nga ana e Rohde&Schwarz u dorëzua garancia e kërkuar për cilësi të realizimit dhe Kontrata u nënshkrua më datën 20.05.2022 me një çmim të kontratës prej 613.097,86 euro. Pas dorëzimit të garancisë bankare për para pagesë dhe faturës për para pagesë nga ana e Rohde & Schwarz, deri te BERZH u dorëzua Aplikacioni për tërheqjeje të mjeteve. PAGESA e faturës për para pagesë u realizua më datën 08.08.2012, me këtë veprim Kontrata hyri në fuqi. Të gjitha hapat e procedurës së tenderit u përcollën me - No Objection (me asnjë kundërshtim) nga ana e BERZH.

Realizimi i fazave të këtij projekti gjatë vitit 2022 u zhvillua brenda afateve të përcaktuara. Gjatë muajit dhjetor në Bukuresht ka përfunduar me sukses testimi FAT (Factory Acceptance Test), pas së cilës pajisjet do të dërgohen në Shkup.

Komponenti i paraparë i projektit për VCS-në e re është planifikuar të finalizohet në tremujorin e dytë të vitit 2023.

#### **4.1.4 Furnizimi, instalimi dhe testimi i radarit të ri vrojtues sekondarë MODE-S**

Radari sekondarë vrojtues - Mode-S (Mode-S Enhanced Surveillance Ground Station Implementation) do të rrisë ndjeshëm besueshmërinë e të dhënave të radarit, gjë që do të ndikonte drejtpërdrejt në kapacitetin dhe sigurinë e trafikut ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në pajtim me rregullat dhe procedurat e prokurimit të BERZH dhe në përputhje me Kontratën e huamarrjes me BERZH, është përcaktuar që i njëjti të realizohet përmes metodës së prokurimit - Thirrje e hapur.

Pas zbatimit të procedurës së prokurimit, raporti i vlerësimit me rekomandimin për lidhjen e kontratës i është dërguar BERZH-it për miratim dhe pranuar përgjigjen miratuese - NO OBJECTION më datën 14.08.2017.

Në pajtim me Ekstraktin nga Draft - procesverbali i seancës së 63-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të mbajtur më datën 10.04.2018, Këshilli drejtues i "M-NAV" SH.A. - Shkup mori vendim për ndërprerjen e procesit të filluar për blerjen e një radari të ri të vëzhgimit sekondar Mode-S, për faktin se kontrata për qiradhënien e tokës private ishte ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga qiradhënësi dhe për këtë arsye duhet të përcaktohet lokalitet i ri në suaza të truallit shtetërorë me qëllim të instalimit të radarit të ri Mode-S. Më datën 09.05.2018, nga ana e BERZH u dorëzua miratimi për ndalesë të procesit të prokurimit dhe shpalljen e një prokurimi të ri me specifikim teknik të reviduar dhe instalimin e pajisjeve në një lokalitet të ri të përshtatshëm.

Gjatë vitit 2019, janë realizuar më shumë analiza për përzgjedhjen e një lokacioni të ri të përshtatshëm dhe u përgatit dokumentacion i ri (i reviduar) i tenderimit, duke përfshirë specifikimin teknik të rishikuar që parashikon instalimin e pajisjeve të reja (radarit) në një vendndodhje tashmë ekzistuese si një zgjidhje më e përshtatshme (hapësirat e "M - NAV" SH.A. – Shkup, me vendndodhje në Aeroportin



Ndërkombëtar të Shkupit), d.m.th. realizimin e zëvendësimit të pajisjeve ekzistuese të vjetra dhe të skaduara që janë në funksion për më shumë se 25 vite (radari Tomson).

Pas përgatitjes së dokumentacionit të plotë në formatin e përshtatshëm për e-portalin e prokurimit të BERZH-it (ECEPP), procedura e tenderit filloi më datën 14.06.2021, me publikimin e Ftesës për dorëzimin e ofertave në ECEPP. Faza e dytë filloi më datën 21.01.2022 dhe zgjati deri më datën 31.03.2022 me hapjen e ofertave nga tre kompanitë që hynë në këtë fazë. Për shkak të lartësisë së ofertave, të cilat ishin pothuajse dyfish më lartë krahas çmimit të parashikuar të furnizimit (për shkak të rritjes drastike të çmimeve të tregut të shkaktuar nga kriza energjetike dhe financiare në Evropë), pas vlerësimit të ofertave të plota dhe pas miratimit nga ana e BERZH, u zvogëlua fushëveprimi i tenderit dhe pasoi anulimi i 2 komponentëve nga tenderi, kështu që prokurimi u reduktua vetëm në komponentin e domosdoshëm, radari MSSR, në mënyrë që të mos vihej në dyshim ofrimi i sigurt i shërbimeve të navigacionit ajror. Më në fund, u dërgua Letër Pranimi dhe Kontrata për furnizimin e sistemit Mode-S deri te kompania e renditur si ofertues i parë - Leonardo S.p.A. nga Italia. Nga ana e kompanisë Leonardo S.p.A. është dorëzuar garancia e kërkuar e cilësisë së performancës realizuese, pas kësaj pasoi edhe nënshkrimi i Kontratës më datën 02.12.2022 me çmimin e kontratës prej 2.165.983,65 euro. Në fillim të vitit 2023, pritet dorëzimi i garancisë bankare për para pagesën dhe fatura e para pagesës nga ana e Rohde & Schwarz, pas kësaj do të pasoj dorëzimi i Aplikimit për tërheqjeje të mjeteve dhe me këtë veprim Kontrata do të hyj në fuqi. Të gjitha etapat e procedurës së tenderit u ndoqën me qëndrimin - No Objection (Asnjë Kundërshtim) nga ana e BERZH.

Është paraparë që komponenti projektues për radarin e ri Mode-S të finalizohet deri në fillim të vitit 2024.

#### ***4.1.5 Shërbimet konsultuese për asistencë të Njësitit për implementim të Projektit për sendërtim të sistemit maqedonas për navigacionin ajror 02***

Më datën 05.07.2018 "M-NAV" SH.A. - Shkup lidhi Kontratën për shërbime konsulente për asistencë të Njësisë për implementimin e "Projektit për sendërtimin e sistemit të navigacionit ajror të Maqedonisë - faza e dytë" me kompaninë Egis Avia, e cila është përzgjedhur përmes procedurës së prokurimit në përputhje me politikat dhe rregullat të BERZH, për përzgjedhjen e një konsulenti, me një periudhë të implementimit prej dy viteve.

Me qëllim të finalizimit të komponentëve të projekteve, më datën 05.07.2022 u nënshkrua Amendamenti nr. 3 i Kontratës për shërbimet e konsulencës për asistencën e PIU-së, të lidhur me Egis Avia, me të cilin u prolongua vlefshmëria e kontratës edhe për 2 muaj shtesë, përkatësisht deri në muajin shtator të vitit 2022.

Në periudhën referuese, PIU në vazhdimësi morri pjesë në aktivitetet lidhur me tërheqjen e fondeve nga BERZH. Takimet me konsulentin në lidhje me realizimin e projekteve janë realizuar kryesisht përmes mbajtjes së telekonferencave. Gjithashtu janë realizuar konsultime të vazhdueshme përmes postës elektronike në lidhje me fazën e dytë të dy procedurave të tenderit (prokurimi i radarit - Mode-S dhe prokurimi i sistemit VCS), konsultimet në lidhje me realizimin e Kontratës për prokurimin e sistemit të ATM, si dhe konsultimet në lidhje me realizimin e Kontratës për furnizimin e sistemit VHF. Në bashkëpunim me Egis Avia, janë përgatitur dy raporte tremujore për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 që u dorëzuan deri te

BERZH, që ishin për ecurinë në realizimin e projekteve, si dhe Raporti përfundimtar për shërbimet e realizuara të konsulencës.

## **4.2 Programi për investimet kapitale të “M-NAV” SH.A. – Shkup, të financuara nga mjetet pronësore**

### **4.2.1 Komponentët e përcaktuara për sistemin e ri të ATM**

Prokurimi i monitorëve (monitorët ATC 2Kx2K), 4 printerë termikë (Toshiba B SA4T G) dhe 15 terminale IDS (kompjuterë me model të caktuar sipas specifikimeve të marra nga integruesi i sistemit të ri të ATM - Leonardo) si pjesë e sistemit të ri të ATM-së, sistemi me të cilin do të zëvendësohen pajisjet ekzistuese.

Procedura u publikua përmes SEFP (sistemi elektronik për furnizime publike) dhe për të njëjtin u lidh kontrata me OE TCN Shqipëria.

### **4.2.2 Furnizimi i dy burimeve të pavarura redundande të furnizimit me energji elektrike**

Me furnizimin e 2 burimeve redundante të furnizimit me energji elektrike do të plotësohen nevojat si të ndërtesës ekzistuese ashtu edhe të ndërtesës së re të ATM.

Hartimi i specifikacionit teknik ishte shumë i gjerë dhe nuk është finalizuar, duke kërkuar nga të gjitha sektorët në "M-NAV" SH.A. - Shkup të koordinohen me njëri-tjetrin në mënyrë që të mos ndalet procesi i funksionimit pas realizimit të furnizimit të sistemit. Ky furnizimin nuk është realizuar në vitin 2022, duke marrë parasysh implikimet financiare të Shoqërisë që u shkaktuan nga pandemia me Covid-19.

### **4.2.3 Adaptimi i hapësirave të përkohshme për qëllime teknike**

Përshtatja e ambienteve të përkohshme për qëllime teknike është e nevojshme në mënyrë që sistemet e reja VCS, VHF dhe VRRS të instalohen dhe të vihen në përdorim të ndërlidhur me sistemin aktual të ATM, pavarësisht nga procesi i instalimit të sistemit të ri të ATM, i cili gjithashtu përfshin një sallë teknike-operative. Kjo do të mundësojë zëvendësimin e sistemeve ekzistuese në kohë më të shpejtë, përkatësisht do të rritet siguria e gjithë sistemit të ATM.

*Për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme dhe pandemisë me Covid – 19, dhe në pajtim me Vendimin e Këshillit drejtues të “M-NAV” SH.A. – Shkup me nr. 02-710/3 të datës 03.04.2020, investimet kapitale nga mjetet pronësore u prolonguan për realizim për vitin 2022. Procedura ishte e paraparë në Planin për prokurime publike për vitin 2022 dhe e njëjta pas dorëzimit të Lejes nga ana e Këshillit mbikëqyrës do të shpallet përmes SEFP.*

### **4.2.4 Konvertimi i sistemit për ngrohje / ftohje nga përdorimi i naftës me përdorimin e gazit natyrorë**

Me prokurimin dhe instalimin e sistemit WAM do të përmbushen kërkesat si dhe specifikimet teknike të përshkruara në standardin EUROCAE ED-142. Në periudhën e ardhshme do të realizohet një lidhje me sistemin e ri të ATM, i cili do të

mundësojë saktësi më të madhe, mirëmbajtje më të thjeshtë, si dhe përfitim më të lartë financiar.

Prokurimi nuk ishte i paraparë në Planin për prokurime publike për vitin 2022.

#### **4.2.5 Furnizimi i softuerit, harduerit dhe procedurat për siguri të sistemeve informatike**

Për të ruajtur nivelin e lartë të cilësisë, qasjen dhe vazhdimësinë e shërbimeve nga "M-NAV" SH.A. - Shkup, është e nevojshme zëvendësimi i tyre me shërbime të reja që do të mundësojnë ruajtjen e nivelit të shërbimit.

Zëvendësimi duhet të zbatohet mbi:

- Sistemin ILS të përcaktuar për aeroportin Shën Apostulli Pali në Ohër;
- Pajisja DME e përcaktuar për aeroportin Shën Apostulli Pali në Ohër;
- Pajisja DME e përcaktuar për Aeroportin ndërkombëtarë në Shkup, dhe
- Pajisja DVOR e përcaktuar për aeroportin Shën Apostulli Pali në Ohër.

Pëlqimi nga BERZH për realizimin e këtij projekti është pranuar në muajin prill të vitit 2020, por personat kompetentë për fillimin e procedurës kanë konstatuar një pjesë plotësuese që nuk ishte paraparë në vetë dokumentacionin e tenderit dhe për këtë arsye pasuan ndryshime të dokumentacionit. Procedura nuk ishte e parashikuar në Planin për prokurime publike për vitin 2022.

## **5 Politika e resurseve njerëzore**

**S**eksioni për resurse njerëzore pranë "M-NAV" SH.A. – Shkup gjatë vitit 2022, në përgjithësi iu kushtua ofrimit të logjistikës dhe përkrahjes këshillëdhënëse për Sektorët / Seksionet tjera dhe për të punësuarit në lidhje me të gjitha çështjet lidhur me resurset njerëzore. Seksioni u orvat që të realizohet politika dhe programi i planifikuar për resurset njerëzore, gjithashtu vazhdoi edhe me realizimin e politikës tani më të përcaktuar dhe miratuar për realizim të veprimtarive dhe aktiviteteve lidhur me zhvillimin e fuqisë së punës, promovimit të menaxhimit me resurset njerëzore. Në periudhën nga muaji janar deri në muajin dhjetor të vitit 2022, Seksioni për resurse njerëzore në fushëveprimin e tij realizoi këto aktivitete me sa vijon:

- Përcjelljen dhe zbatimin e legjislativit pozitiv ligjorë dhe nën ligjor dhe të akteve interne të Shoqërisë, me të cilët rregullohen të drejtat lidhur me marrëdhëniet e punës;
- Zbatimin e Vendimeve të miratuara nga ana e Këshillit drejtues;

- Përpilimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të rregullores për sistematizim të vendeve të punës si dhe përpilimin e tekstit të pastruar të njëjtit;
- Përpilimin e propozimeve për politikat dhe procedurat për resurset njerëzore;
- Ofrimin e mendimeve dhe informimin në kohë të Këshillit drejtues për punët që kanë të bëjnë me resurset njerëzore në suaza të Shoqërisë;
- Planifikimin e punësimeve për vitin 2023, përgatitjen e të dhënave për të njëjtit dhe dorëzimin e tyre deri te seksioni i detyruar për përpilimin e Planit vjetor financiarë të Shoqërisë për vitin 2023;
- Përpilimin e kërkesës për dhënien e pëlqimit buxhetor deri te ministria përkatëse, përpilimin e shpalljeve për punësime, shpalljen e tyre në shtypin ditor dhe deri te APRMV;
- Pjesëmarrjen gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për punësim në kohë të caktuar si studentë;
- Përpilimin e Kontratave për punësime dhe të Anekseve të kontratave për punësime për të punësuarit në Shoqërinë;
- Përpilimin e akteve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës (aktvendimet dhe / ose Marrëveshjet);
- Përpilimin e aktvendimeve për mungesat në punë (pushimet vjetore, pushimet rekreative, mungesat e paguara, mungesat e pa paguara), aktvendimet për udhëzim në pushim zyrtar, aktvendimet për pagesën e ndihmës financiare, aktvendimet për pagesat në rastet e pensionimit të punonjësve të Shoqërisë, aktvendimet për refundim të mjeteve për trajnime si dhe aktvendimet për pagesën e realizimit të punës në vendin e rivlerësuar të punës;
- Përpilimin e planeve për pushimet vjetore në bashkëpunim me seksionet tjera si dhe përpilimin e vërtetimeve lidhur me marrëdhëniet e punës për të punësuarit sipas bazave të ndryshme;
- Përpilimin e të gjitha të dhënave për të punësuarit nga baza e të dhënave personale dhe dorëzimin e tyre deri te seksionet për nevojat e tyre;
- Azhurnimin e bazës së të dhënave për të punësuarit në Shoqërinë;
- Përpilimin e strukturës së të punësuarve në Shoqërinë;
- Përpilimin e evidencës elektronike për nevojat e seksionit: punësimet e reja, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, vënien në qetësi të marrëdhënies së punës, pushimet vjetore dhe rekreative, mungesat e paguara dhe të pa paguara, udhëtimet zyrtare, pushimet mjekësore dhe evidentimet tjera;
- Përpilimin dhe dorëzimin e të dhënave për të punësuarit deri te kompanitë e sigurimit për sigurimin e të punësuarve;
- Përpilimin e të dhënave për kontrollimet mjekësore për personelin që nuk i përket personelit të navigacionit ajror;
- Përpilimin e vërtetimeve për fletë paraqitjen tatimore;
- Përpilimin dhe dorëzimin e raporteve për vendet e lira të punës në nivele tremujore deri te Enti për Statistikë;
- Përpilimin e evidencave për të punësuarit që fitojnë të drejtat për regres të pushimit vjetor, shpërblimet jubilarë dhe pagën e 13-të;
- Përpilimin e raportit për të dhënat për përfaqësimin përkatës dhe të drejtë të përkatësve të bashkësive etnike dhe të dhënat për strukturën gjinore dhe nivelin e përgatitjes arsimore për të punësuarit në “M-NAV” SH.A. – Shkup dhe dorëzimin e tij deri te Avokati popullorë në nivel vjetor;
- Azhurnimin e dosjeve personale dhe arkivimin e dokumentacionit;
- Pjesëmarrjen në aktivitetet e punës si anëtarë të komisioneve të ndryshme;
- Pjesëmarrjen në aktivitetet e punës së Këshillit mbikëqyrës;
- Pjesëmarrjen në procesin e negociatave me organizatat përfaqësuese sindikale;

- Paraqitjen / çregjistrimin e të punësuarve në Agjencinë për punësime dhe në Fondin për shëndetësi dhe në Fondin për sigurime pensionale dhe invalidore;
- Bashkëpunimi me Agjencinë për punësime të përkohshme (procedimin e Kontratës për personat e angazhuar si dhe evidentimin e raporteve të punës dhe faturave të dorëzuara);
- Kompletimin e dokumentacionit të tërësishëm, përkthimin e të njëjtit, dorëzimin deri te APRMV për paraqitje / çregjistrim të personave shtetas të huaj të cilët përmes projekteve janë të angazhuar për ofrimin e shërbimeve për Shoqërinë;
- Bashkëpunimi me Gazetën zyrtare dhe Praksis për përcjelljen e legjislativit pozitiv ligjo në vendin tonë, dhe
- Bashkëpunimin dhe komunikimin me institucionet tjera sipas nevojave lidhur me detyrën zyrtare.

## 6 Bashkëpunimet rajonale; FAB's

Sipas rregulloreve SES, hapësira e sipërme ajrore në suaza të ICAO Evropiane dhe Afrikane – International Civil Aviation Organization (EUR and AFI ICAO region) - duhet të rikonfigurohet në FAB – e (Functional Airspace Blocks - Blloqe funksionale të hapësirës ajrore) si një nga mënyrat për të arritur objektivat e SES. Organizimi i hapësirës ajrore në blloqe funksionale duhet të përmirësojë planifikimin dhe rrjedhën e trafikut ajror, të rrisë efikasitetin e aviacionit në Evropë, të minimizojë vonesat dhe të optimizojë kapacitetin e hapësirës ajrore duke përmbushur kërkesat e të gjithë përdoruesve të tij.

Përveç vendeve anëtare të BE-së, rregulloret e SES i detyrojnë edhe vendet që kanë nënshkruar marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe të transportit ajror me Bashkimin Evropian. Këto vende përfshijnë Norvegjinë, Zvicrën, vendet e Ballkanit Perëndimor, ku bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Islanda, e cila nuk është e detyruar të formojë FAB-in meqenëse nuk është në suaza të rajonit evropian të ICAO-së.

Sot, ekzistojnë nëntë iniciativa FAB që përfshijnë të gjitha vendet e detyruara. Në rajonin më të afërt, si iniciativa ekzistuese janë BlueMed FAB dhe Danube FAB.

Në procesin e pozicionimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me rastin e përcaktimit të strategjisë për t'iu bashkuar iniciativës së caktuar FAB, para se gjithash duhet të merret parasysh pozita gjeografike dhe rrjedhat e trafikut ajror për të optimizuar kapacitetet, nevojën për të optimizuar ndërveprimin e sistemeve dhe krijimin e legjislativitetit dhe standardeve të përbashkëta ndërmjet anëtarëve të një FAB-i të caktuar.

Më datën 03.11.2011, në Shkup u mbajt takimi i zëvendësministrave të transportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, ku

morën pjesë delegacione nga autoritetet e navigacionit ajror të dy vendeve. Në këtë takim, zëvendësministri bullgar i dorëzoi ftesën Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'iu bashkuar Danube FAB si vëzhgues. Më datën 8.12.2011, në Sofje u mbajt takimi ndërmjet delegacioneve të Bulatsa dhe Agjencisë së navigacionit ajror civil të Republikës së Bullgarisë nga njëra anë dhe "M-NAV" SH.A. - Shkup dhe Agjencisë së navigacionit ajror civil të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në këtë takim pala bullgare i prezantoi proceset lidhur me statusin dhe gjendjet e Danube FAB.

Më datën 28.10.2015, në mbledhjen e gjashtë të Këshillit Menaxhues të Danube FAB, që u mbajt në Sofje, Republika e Maqedonisë së Veriut fitoi statusin e vëzhguesit në të njëjtin. Kësaj i paraprinë takimet dhe konsultimet disavejçare me dhe ndërmjet anëtarëve të Danube FAB, si dhe informacioni i dorëzuar dhe shqyrtuar nga Qeveria e RMV-së.

Në vitin 2019, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes Ministrit të transportit dhe lidhjeve, kërkoi anëtarësim të asociuar në FAB-in Bluemed, me këtë filloi procesi i zyrtarizimit të rolit tonë në këtë FAB. Si pasojë e të gjitha aktiviteteve të mëparshme, si dhe takimit të Bluemed GB (Governing Body - Organit Drejtues) i cili u mbajt më datën 5 shkurt të vitit 2020 në Nikosi, Qipro, më datën 27.04.2020, Republika e Maqedonisë së Veriut nënshkroi Marrëveshjen e bashkëpunimit me vendet anëtare të FAB-it Bluemed. "M-NAV" SH.A. – Shkup, gjatë vitit 2022 realizoi pjesëmarrja aktive në takimet e organizuara në kuadër të grupeve të themeluara që u organizuan nga distanca për shkak të praktikitetit dhe kufizimeve të caktuara për shkak të virusit Covid-19.

Gjatë vitit 2022, Këshilli Menaxhues i Danube FAB, nga Republika e Maqedonisë së Veriut kërkoi që të prononcohet në lidhje me statusin e anëtarësimit në këtë iniciativë, duke pasur parasysh periudhën e gjatë kohore në të cilën kemi statusin e vëzhguesit. "M-NAV" SH.A. – Shkup, në drejtim të prononcimit, do të përgatisë një analizë të kostove - përfitimit, e cila pasi të përgatitet do t'u prezantohet palëve të interesit.

## **7. Përmbushja e objektivave të përkufizuara për vitin 2022**

### **7.1 Arritja e Standardeve të sigurisë, sigurimit dhe cilësisë**

**S**eksioni për siguri, sigurim dhe cilësi - SSSC (nga data 01.03.2023, u ri emërua si Seksioni për sistem të integruar të menaxhimit – SIM), në pajtim me procedurat e brendshme dhe strukturës organizative parashtrohet drejtpërdrejt nën Këshilli drejtues të "M-NAV" SH.A. - Shkup. Në vitin 2022 me sukses realizoi një pjesë të aktiviteteve në përputhje me planin vjetor të përcaktuar nga Komiteti i Sigurisë pranë "M-NAV" SH.A. - Shkup si dhe detyrat e përcaktuara në Udhëzimin për menaxhimin e sigurisë (Safety Management Manuel), Procedurat nga sistemi për menaxhim me cilësinë dhe Doracakun për menaxhim të sigurimit në "M-NAV" SH.A. - Shkup, si dhe qëllimet e përcaktuara nga Plani strategjik afarist i "M-NAV" SH.A – Shkup.

Konkluzioni kryesor në këtë raport është se për vitin 2022, të gjithë treguesit e sigurisë, ato reaktivë dhe pro-aktivë, tregojnë se siguria në suaza të "M-NAV" SH.A. - Shkup është mbajtur brenda caqeve të përcaktuara, kurse në disa pjesë të menaxhimit të sistemeve të sigurisë, sigurimit dhe cilësisë, gjendja është përmirësuar në masë të konsiderueshme.

Gjatë vitit 2022, në kuadër të aktiviteteve të rregullta vjetore të Seksionit, janë realizuar një numër i konsiderueshëm i kontrollimeve për ngjarjet e sigurisë dhe janë zbatuar rekomandimet e nxjerra, u realizuan vlerësimet e ndryshimeve të vogla / të

mëdha në suaza të sistemit funksional ekzistues, si dhe plotësimet e vlerësimit të ndryshimeve të mëdha të planifikuara që janë pjesë e projekteve të BERZH-it dhe Planit Vjetor për prokurime publike të "M-NAV" SH.A. – Shkup.

### **7.1.1 Siguria**

Seksioni për siguri (SS) në Seksionin e SSC (nga data 01.03.2023 është riemëruar në Seksionin për sistemin e menaxhimit të Integruar - SMI) gjatë vitit 2022 ka punuar në realizimin e aktiviteteve të planifikuara nga plani vjetor, planet e veprimit, qëllimet strategjike të përcaktuara në SSP, si zbatim të sigurt të aktiviteteve në masat e miratuara gjatë pandemisë. Gjatë vitit 2022, trafiku ajror ka shënuar rritje, dhe aktivitetet janë zhvilluar me dinamikën e zakonshme dhe pa vështirësi të mëdha.

**KPI 1** – U plotësua pyetësori i Eurocontrol/CANSO SoE in SMS 2022 measurement questionnaire. Pas botimit të Raportit përfundimtar lidhur me matjen e maturitetit të sigurisë së sistemit për menaxhim të sigurisë në "M-NAV" SH.A. - Shkup mund të themi se SMS maturity level pranë "M-NAV" SH.A. - Shkup është në nivelin e lartë "D", që nënkupton - Level D (Assured), përkatësisht - Nivelin D (të garantuar), gjegjësisht konfirmohet se maturimi i Shoqërisë në procesin e menaxhimit të sigurisë është i siguar. Pyetësori Standard of Excellence (i Standardit të Ekselencës) u plotësua gjatë tremujorit të fundit të vitit 2022.

**KPI 2** - RAT tool - përdoret në të gjitha ngjarjet e sigurisë me seriozitetin "C" që dëshmon se të gjitha incidentet e rëndësishme hetohen në mënyrë plotësuese përmes veglës softuerike nga Eurocontrol me qëllim që të evitohet vlerësimi subjektiv - përcaktimi i shkallës së seriozitetit me frekuencën e shfaqjes (severity & Likelihood).

**KPI 3** - Just Culture (Kultura e drejtësisë) në lidhje me këtë tregues kryesor, Shoqëria i kushton rëndësi të madhe zbatimit të parimeve të Just Culture, përkatësisht krijimit dhe zhvillimit të një kulture të drejtësisë dhe mosndëshkimi vetëm për qëllimin e raportimit të ngjarjeve pa frikën nga pasojat. Nga ngjarjet e raportuara të sigurisë, dy ishin lëndë e shqyrtimit nga Komiteti i drejtësisë.

Si pjesë e aktiviteteve të rregullta të SSSC do të theksojmë edhe zbatimin dhe përgatitjen e planeve korigjuese për të gjetjet e konstatuara nga ACV dhe gjetjet e brendshme, aktivitetet përcjellëse - Follow-up për rekomandime, monitorimin e performancës së sigurisë - safety performance dhe realizimin e planeve të veprimit.

Koordinim i rregullt me Oficerët e sigurisë, Grupin e sigurisë dhe Komitetin e sigurisë. Janë mbajtur më shumë takime dhe janë mbajtur procesverbale në përputhje me procedurat e brendshme të menaxhimit të sigurisë.

Me dinamikë të zakonshme u realizua bashkëpunimi i përcaktuar ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar me të gjitha faktorët në navigacionin ajror (Eurocontrol, CANSO, FAB Danube/BlueMed, TAV, Kompanitë ajrore, NATO, etj.). SSSC punoi në drejtim të përmirësimit të bazës së të dhënave të sigurisë - Safety data base.

Gjatë vitit 2022, në bazën e OBOK janë regjistruar 9 ndryshime, nga të cilat disa akoma janë në rrjedhë dhe do të bëhen pjesë e punës së SSSC edhe gjatë vitit 2023. Kemi të bëjmë me azhurnimet e dokumentacionit nga sistemi për menaxhim të siguri në "M-NAV" SH.A. – Shkup, dhe me këtë edhe ndryshimi i disa prej proceseve me qëllim të harmonizimit me kërkesat e legjislativit të BE-së me nr. 373/2017.

Puna operative e personelit për mirëmbajtjen e kompetencave u realizua në mënyrë të rregullt dhe me kushtet e parashtruara në suaza të Direktivave operative të dhëna nga ACV.

Janë dhënë edhe dy "Safety letters", nga të cilët njëra ishte e përcaktuar për ngritjen e vetëdijes dhe zgjuarsisë së realizuesve operativ në suaza të seksioneve

OBKL – FMP dhe APP – TVR (Supervizorët, KL dhe PKL) për njoftimin tyre në lidhje me rekomandimet që pasuan nga ngjarjet e kontrolluara të sigurisë gjatë vitit 2022. Letra tjetër kishte të bëjë me ngritjen e vetëdijes dhe zgjuarsisë së realizuesve operativ në suaza të Seksionit për Informacione të navigacionit ajror.

### **7.1.1.2 Analiza e trendit të ngjarjeve të sigurisë së ATM për periudhën nga 01.01 deri më 31.12.2022**

Janë paraqitur 43 ngjarje operative (ATM), 23 teknike, dy AIS dhe 27 kallëzime vullnetare.

Në vijim pason tabela e ngjarjeve gjatë viteve të kaluara, me analizën e trendeve.

**Tabela 7.1: Numri i ngjarjeve ATM për periudhën e viteve 2017-2022**



## **7.1.2 Sigurimi**

### **7.1.2.1 Sigurimi fizik dhe sajber siguria**



Në sferën e sigurisë fizike të objekteve dhe personave, pas përfundimit të zbatimit të sistemit të kontrollit të qasjes dhe video monitorimit në objektet e KL Shkup dhe Ohër, në vitin 2022 është implementuar sistemi për sigurimin e pajisjeve të jashtme të navigacionit - jashtë zonës "airside" ajrore. Masat mbrojtëse janë implementuar edhe në pajisjet e jashtme, me sa vijon:

- Radari Selex – "Banjski Rid"
- VOR Shkup
- VOR Ohër
- Radari Indra - "Gorenička çuka", Ohër
- VOR - Ponikva, Koçanë
- Middle Marker – Petrovec
- NDB-DME – Izdeglavje, Ohër
- COM Site – Gradishte, Shën Nikollë
- NDB-DME – Konjare e Madhe, Prilep
- Out Marker – Kartllanovë, Shkup

Në të gjitha pajisjet është instaluar një sistem identik i sigurisë, i cili përfshin video monitorimin, sistemin e alarmimit dhe sistemin për njoftimin e ngjarjeve.

Ngjarjet përcillen në një lokalitet qendror dhe monitorohen nga një vend – vend paraqitja e "M-NAV" SH.A. - Shkup. Është ndërtuar një vend i ri për paraqitje pranë hyrjes së parkingut përballë ndërtesës së "M-NAV" SH.A. – Shkup në afërsi të aeroportit. Në këtë mënyrë kompletohet tërësisht sistemi për sigurimin fizik të objekteve të "M-NAV" SH.A. - Shkup.

Për sa i përket implementimit të sistemeve për rezistencë ndaj sulmeve kibernetike (cyber resilience), gjatë vitit 2022 janë implementuar "firewalls" të rinj të gjeneratës së fundit. Në këtë mënyrë, mbrojtja rrethuese u përmirësua në masë të konsiderueshme.

Sistemi i mbrojtjes "EndProtection" – për mbrojtjen e kompjuterëve të klientëve me instalimin e "EndProtection CheckPoint" në mënyrë të rregullt u monitoruan. Në vitin e kaluar 2022, u manifestuan incidente të vogla që u tejkaluan me sukses.

Si prioritet i vazhdueshëm i "M-NAV" SH.A.- Shkup është ngritja e nivelit të trajnimit të punëtorëve në suaza të Seksionit për siguri, angazhim të vazhdueshëm në drejtim të ngritjes së nivelit të vetëdijes dhe kulturës së sigurisë tek të gjithë të punësuarit në "M-NAV" SH.A. - Shkup.

Për sa i përket zbatimit të standardit ISO 27001 – Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacioneve, zbatimi është shtyrë për në vitin 2023.

Motivimi i punonjësve për të raportuar ngjarjet lidhur me sigurinë, paraqet një nga prioritetet kryesore gjatë vitit 2023.

### **7.1.2.2 Vlerësimet e sigurisë**

Gjatë vitit 2022 u realizua vlerësimi i sajber (cyber) kërcënimeve si dhe analiza e situatës aktuale përmes sajber sigurimit të "M-NAV" SH.A. – Shkup.

### **7.1.2.3 Mbikëqyrjet dhe masat e kontrollimit të cilësisë së shërbimit**

Në pajtim me planin për mbikëqyrje dhe masave të brendshme, gjatë vitit 2022 u realizuan kontrollimet e sistemit të sigurisë fizike. Gjatë muajit dhjetor të vitit 2022 u planifikua stërvitja lidhur me kërcënimet me vendosje të bombës, por e njëjta u prolongua për vitin 2023.

### **7.1.3 Cilësia**

Indikatorët kryesorë të suksesit lidhur me Sistemin për menaxhim me cilësinë për vitin 2022, janë:

#### **a) Dokumentacioni**

- Gjatë vitit 2022 filloi azhurnimi i dokumentacionit të përgjithshëm të Sistemit për Menaxhim të Cilësisë, me qëllim të harmonizimit me kërkesat e Rregullativës së BE-së nr. 373/2017. Mirëmbajtja e portalit të intranetit të përditësuar të "M-NAV" SH.A. – Shkup me dokumentacionin e sapokrijuar në pajtim me standardin ISO 9001:2015; ISO 18001:2015 dhe ISO 45001:2018;
- Përgatitja e listës së dokumenteve, shkresave, marrëveshjeve të bashkëpunimit, me qëllim të krijimit të një pasqyre të plotë të dokumentacionit në "M-NAV" SH.A. – Shkup.
- Pjesëmarrja në procesin e krijimit dhe rishikimit të procedurave të dorëzuara, udhëzimeve, kontratave të dorëzuara nga seksioneve në suaza të "M-NAV" SH.A. - Shkup. Pjesëmarrja aktive në menaxhimin e ndryshimeve duke aplikuar metodat e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

#### **b) Auditimi i brendshëm**

- Mbikëqyrjet e planifikuara dhe të realizuara nga SMC, ofruan një pasqyrë të funksionimit të të gjithë sektorëve dhe seksioneve në "M-NAV" SH.A. - Shkup dhe në të njëjtën kohë ofruan një pasqyrë të mangësive dhe hapësirës për përmirësim në fushën e menaxhimit të standardeve të zbatuara në "M-NAV" SH.A. – Shkup.
- U realizua kontrollimi i brendshëm i sistemeve për vitin 2022 në periudhën kohore 21-25.02.2022 dhe u përpilua Raporti MNV-920-101.03 i datës 14.03.2022;
- Më datën 07.04.2022 u mbajt takimi me qëllim të ri shqyrtimit të SMC, u përpilua Procesverbal i rishqyrtimit MNV-930-101.01/22 i datës 26.04.2022;

- U realizua kontrollimi për përcjellje të rekomandimeve nga kontrollimi i brendshëm në periudhën 14-18.11.2022 në pajtim me Raportin MNV-920-101.03 të datës 14-18.11.2022.

### **c) Safety Survey**

Gjatë vitit 2022 kanë filluar përgatitjet për realizimin e Safety Culture Survey në bashkëpunim me Eurocontrol. Për këtë qëllim janë mbajtur disa takime me përfaqësuesit nga Eurocontrol dhe është përcaktuar modeli sipas të cilit do të kryhet mbikëqyrja e sigurisë gjatë vitit 2023.

### **ç) Trajnimet**

- Pjesëmarrja në trajnimin Management Systems in the context of ATM/ANS [GEN-MANS] gjatë muajit mars të vitit 2022.

### **d) Trajtime të realizuara nga seksioni për Cilësi / Siguri**

- Më datën 22.09.2022, u realizua një trajnim i brendshëm / instruktiv / pa provime, në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë (teori dhe ushtrime) në përputhje me programin e shkurtuar të trajnimit nga ana e CO të KL, PKL dhe FMP.

### **dh) Certifikimi**

Më datën 29.04.2022 u realizua një auditim i jashtëm nga ana e kompanisë certifikuese TUV Nord dhe u konstatua se Sistemi është në përputhje me kërkesat e standardit përkatës dhe në vazhdimësi arrin politikat dhe qëllimet e përcaktuara dhe se aplikimi i sistemit është efikas. Në përputhje me gjetjet e auditimit, janë lëshuar / siguruar certifikatat ISO 9001:2015; ISO 18001:2015 dhe ISO 45001:2018.

### **e) Vlerësimet e sigurisë**

Seksioni për cilësi / siguri u përfshi gjatë realizimit të vlerësimeve të sigurisë, me sa vijon:

- SA 01/2022- SA 02/2022-;
- SA 03/2022-;
- SA 05/2022-;
- SA 06/2022-;
- SA 07/2022-;
- SA 08/2022-;
- SA 09/2022-.

## **7.2 Arritja e niveleve të mbrojtjes së mjedisit jetësor**

- Azhurnimi i dokumentacionit lidhur me standardin ISO për mjedisin jetësorë 14001:2015;
- U realizua fushata për përzgjedhje të mbeturinave në pajtim me standardin ISO 14001:2015;
- Monitorim i vazhdueshëm, inkurajim dhe informim për përzgjedhjen e rregullt të mbetjeve dhe reduktimin e materialeve të shfrytëzuara që përdoren më së shumti në kompani.

### **7.3 Fuqizimi i resurseve njerëzore**

Në vitin 2022 në "M-NAV" SH.A. - Në Shkup kanë krijuar marrëdhënie pune 15 (pesëmbëdhjetë) persona, prej të cilëve 7 (shtatë) me afat të pacaktuar dhe 8 (tetë) persona/studentë kanë lidhur marrëdhënie pune me afat të caktuar.

Në vitin 2022, me hyrjen në fuqi të ligjit, gjithsej 14 (katërmëdhjetë) punonjësve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të përfitimit të së drejtës për pensionim. 1 (një) punonjësi i ka përfunduar marrëdhënia e punës me marrëveshje reciproke, dhe 1 (një) punonjësi marrëdhënia e punës iu vë në qetësi.

Numri i të punësuarve në Shoqëri me datën 31.12.2022 është 305 punëtorë. Funkcionimi ka vazhduar me të njëjtën dinamikë dhe profesionalitet, gjatë kësaj në vazhdimësi është marrë parasysh shfrytëzimi optimal i burimeve njerëzore.

### **7.4 Rritja e efikasitetit të shpenzimeve**

Me hapjen e hapësirës ajrore mbi Kosovë dhe me rritjen e trafikut në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përveç shfrytëzimit optimal të resurseve operative, u arrit përmirësim i dukshëm në efikasitetin e shpenzimeve në "M-NAV" SH.A.- Shkup. Ky trend pozitiv vazhdoi gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së dytë të referencës nga viti 2015 deri në vitin 2019, si dhe fillimit të periudhës së tretë të referencës RP3 (2020-2024).

Informacion më të detajuar për nivelin e këtij treguesi në vitin 2022 vijon në rubrikën - Treguesit kryesorë të realizimit.

### **7.5 Transparenca ekonomike**

Transparenca ekonomike e funksionimit të "M-NAV" SH.A. - Shkup sigurohet me dorëzimin e raporteve financiare deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Eurocontrol, BERZH dhe Agjencia e aviacionit civil të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### **7.6 Harmonizimi me legjislativin dhe standardet e SES (Qiellit të përbashkët evropian)**

Në vitin 2022 "M-NAV" SH.A. - Shkup vazhdoi të ruajë standardet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror në përputhje me rregulloret vendore dhe rregulloret ndërkombëtare SES, standardet dhe praktikat e rekomanduara.

Kjo është konfirmuar dhe rezulton me zgjatjen e Vërtetimit për aftësimin e ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror – lëshuar për herë të fundit nga Agjencia e aviacionit civil në muajin mars të vitit 2022 dhe me vlefshmëri deri në muajin mars të vitit 2024.

Duke filluar nga viti 2010, Agjencia e aviacionit civil në vazhdimësi ofron Vërtetimin për aftësimin e ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror për "M-NAV" SH.A. - Shkup.

"M-NAV" SH.A. - Shkup në vazhdimësi i përcjell ndryshimet dhe plotësimet më të reja të rregulloreve dhe standardeve ndërkombëtare dhe në përputhje me rrethanat përgatitet për zbatimin e plotë të tyre, ndërsa Agjencia e aviacionit civil përmes inspektimeve dhe kontrolleve të rregullta, në mënyrë plotësuese i kontrollon dhe konfirmon të njëjtit.

Më datën 01.12.2017 hyri në fuqi Marrëveshja shumëpalëshe për Themelimin e Rajonit të përbashkët të navigacionit ajror Evropian (RPNJE).

## **7.7 Përmirësimi i sistemeve ATM/CNS**

Përmirësimi i sistemeve ATM/CNS është paraparë në kuadër të "Projektit për përmirësimin e sistemit të navigacionit ajror të Maqedonisë 02" siç u theksua më lart në pjesën - Investimet dhe zhvillimi.

## **7.8 Optimizimi i menaxhimit me hapësirën ajrore**

Pas hapjes së hapësirës së sipërme ajrore të Kosovës për fluturimet transitore në vitin 2014 dhe pas realizimit të njërit prej projekteve më të mëdha lidhur me organizimin e hapësirës ajrore në rajon, si dhe implementimit të hapësirës ajrore të Free Route Airspace (Rrugës së lirë) në hapësirën tonë ajrore në vitin 2016, gjatë vitit 2020 u vazhdua me optimizimin e strukturës së hapësirës ajrore dhe rritjen e kapaciteteve. Këto procese zbatohen në bashkëpunim me të gjitha vendet fqinje ashtu edhe në rajon më gjerë.

Më datën 02.12.2022, hapësira jonë ajrore u bë pjesë integrale e South East Common Sky Initiative – SECSI FRA (Iniciativës së Qiellit të Përbashkët Juglindor – SECSI FRA), gjatë së cilës u realizuan të ashtuquajturat - cross-border Free Route Airspace (hapësira ajrore e rrugës së lirë ndërkufitare) me Shqipërinë, Serbinë, Malin e Zi, Bosnje dhe Hercegovinën, Kroacinë, Slloveninë dhe Austrinë. Kjo mundësoi përfitime të konsiderueshme për përdoruesit e hapësirës ajrore që udhëtojnë përgjatë aksit Juglindor, duke ofruar linjat më të shkurtra nga Evropa Qendrore deri në Evropën Juglindore, gjë që kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e parametrit të efikasitetit të fluturimit për shkak të uljes së konsumit të karburantit. Në këtë mënyrë, ndikohet pozitivisht mbi mbrojtjen e mjedisit jetësorë përmes uljes së emetimit të CO<sub>2</sub> në atmosferë.

## **7.9 Arritja e qëllimeve të LSSIP (Local Single Sky ImPlementation)**

Me rritjen e vazhdueshme të trafikut ajror në rajonin e Evropës, me rëndësi të veçantë për të gjitha vendet evropiane, si dhe për ofruesit e shërbimeve ANS, është gjetja e zgjidhjeve që do t'i përgjigjen presionit për sa i përket kapacitetit të hapësirës ajrore, ndikimeve mbi mjedisin, integrimin e llojeve të reja të aeroplanëve, sigurinë, si dhe rritjen e shpenzimeve të linjave ajrore për shkak të vonesave dhe rritjes së shfrytëzimit të karburantit.

Korniza funksionale, i cila i përshkruan dhe bashkon të gjitha zgjidhjet teknologjike, duke avancuar cilësinë e shërbimit që u ofrohet përdoruesve si dhe zhvillimin e teknologjive të avancuara që rrjedhin nga programi SESAR, është Master Plani Evropian i ATM-ve.

European ATM Master Plan (Master Plani Evropian i ATM-ve), në kuadër të strategjisë së aero navigacionit të BE-së dhe Single European Sky (QIELLIT të vetëm Evropian), është mjeti kryesor për planifikimin e modernizimit të sistemit evropian të ATM-ve. Ai përcakton prioritetet në zhvillimin dhe aplikimin e teknologjive të reja që nevojiten për të realizuar vizionin SESAR, që përfshinë krijimin e një sistemi ATM plotësisht të adaptueshëm dhe rrezistent, të aftë për të pranuar trafikun ajror në rritje, në mënyrë të sigurt, të besueshëm dhe të qëndrueshëm.

European ATM Master Plan Level 3 Implementation view (Pikëpamja e zbatimit të Master Planit Evropian të ATM-ve të Nivelit 3), si pjesë integrale e European ATM Master Plan (Master Planit Evropian të ATM-ve), përditësohet çdo vit për të pasqyruar ndryshimet në mjedisin global të navigacionit ajror, përmes bashkëpunimit efektiv të ndërsjellë të të gjitha faktorëve në aviacion dhe i adreson ndryshimet në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme (rreth 5 vite).

European ATM Master Plan L3 2022, i pasqyron ndryshimet e gjeneruara nga miratimi i Rregullores së re SES (CP1) nga data 21.02.2021 dhe fokusi kryesor është vënë në harmonizimin dhe unifikimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të synimeve të SESAR, si dhe inkorporimin e Airspace Architecture Study Transition.

European ATM Master Plan L3 Implementation view 2022 përfshin 92 Implementation Objectives, me afate të përkufizuara kohore për implementimin e tyre.

Progresi në lidhje me Implementation Objectives (implementimin e objektivave të përcaktuara), monitorohet nga SJU (SESAR Joint Undertaking) përmes dokumenteve LSSIP (Local Single Sky Implementation) të cilat ofrojnë një pasqyrë të gjerë, të konsoliduar dhe të harmonizuar të progresit gjatë planifikimit dhe zbatimit të elementeve të European ATM Master Plan (Master Planit Evropian të ATM-ve) dhe Rregullores SES dhe të njëjtit janë një pasqyrim i drejtpërdrejtë i angazhimit të agjencive kombëtare civile dhe ushtarake, ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror, si dhe operatorëve të aeroportit, për nga aspekti i zbatimit të tyre. Cilësia e të dhënave nga dokumentet e LSSIP, mundëson që për disa vite me radhë ato të jenë burimi i vetëm për përgatitjen e raportit të zbatimit të ICAO Aviation System Block Upgrades (ASBUs) - (Përmirësimeve të Bllokut të Sistemit të Aviacionit ICAO (ASBUs) për zonën ICAO/EUR.

Në dokumentin LSSIP 2022 për Maqedoninë e Veriut, nga gjithsej 35 Objektiva të implementimit që janë të zbatueshme për vendin tonë, 8 janë zbatuar plotësisht, 21 janë në fazën e zbatimit, 3 janë planifikuar të fillojnë dhe 3 ende nuk janë planifikuar. Shumica e këtyre Objektivave të implementimit që janë në fazën e zbatimit janë të lidhura ngushtë me realizimin e disa projekteve të mëdha në "M-NAV" SH.A. - Shkup, siç janë: New ATM System Project, New VCS with VoIP capability, Supply And Installation Of New Mode S MSSR, PBN Implementation (Projekti i Sistemit të Ri ATM, VCS i ri me aftësi VoIP, Furnizimi dhe instalimi i modalitetit të ri S MSSR, Implementimi i PBN).

## **7.10 Përmbushja e objektivave të Seksionit për revizion të brendshëm**

Qëllimi i revizionit është, nëpërmjet një qasjeje sistematike dhe të disiplinuar, të kontrollojë dhe vlerësojë proceset në Shoqërinë dhe t'i ofrojë siguri të arsyeshme menaxhmentit të Shoqërisë se proceset janë organizuar dhe ekzekutuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet e brendshme të miratuara dhe që burimet ekzistuese të shfrytëzohen në mënyrë ekonomike, me efikasitet dhe efektivitet dhe në funksion

të arritjes së qëllimeve. Me këtë qasje, revizioni i brendshëm rrit “vlerën e shtuar” të Shoqërisë.

Seksioni për revizion të brendshëm i planifikon angazhimet e tij në përputhje me objektivat e Shoqërisë dhe vlerësimin e gjendjes së sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar.

Seksioni ka zbatuar Planin Vjetor të punës së seksionit për vitin 2022 dhe deri në fund të vitit ka përpiluar dy raporte të revizionit për shërbimet e sigurimin dhe një raport të revizionit për shërbimet konsulente. Një angazhim i revizionit të shërbimeve konsulente u bart në vitin 2023; është realizuar revizioni për përcjelljen e rekomandimeve në lidhje me raportin e përpiluar gjatë periudhës së mëparshme; u realizuan edhe angazhime të tjera këshillimore në bazë të vendimeve të Këshillit drejtues të "M-NAV" SH.A. - Shkup lidhur me aktivitetet e udhëheqjes për menaxhimin e rrezeve dhe përcaktimin e masave të kontrollit; pjesëmarrja në vlerësimin, faza e dytë, e dokumentacionit të tenderit, në përputhje me rregullat e reja të BERZH-it për realizimin e procedurave të tenderit për projektet e financuara nga fondet e BERZHI-it; kontrollimin e të dhënave financiare nga raportet tremujore dhe raportin vjetor për operacionet financiare të Shoqërisë për vitin 2021, për sa i përket përputhshmërisë së të dhënave në raportet me të dhënat nga libri kryesor dhe planit financiar të Shoqërisë.

Rekomandimet nga raportet përfundimtare të revizionit duhet të:

- Përmirësojnë dhe fuqizojnë sistemin e kontrolleve të brendshme në mënyrën e dhënies së të dhënave për llogaritjen e detyrimeve tatimore në përputhje me Ligjin për vlerën e shtuar dhe regjistrimin kontabilistik të tyre për qëllime të raportimit financiar, në mënyrë që të sigurohet saktësia dhe tërësia e zbatimit të dispozitave tatimore për llogaritjen dhe kthimin;
- Ndikojnë në harmonizimin e legjislativit lidhur me mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit gjatë angazhimit të punëtorëve;
- Fuqizojnë parimet e menaxhimit të korporatës në fushën e zhvillimit të politikave dhe procedurave të menaxhimit të burimeve njerëzore për planifikimin strategjik të zhvillimit të burimeve njerëzore; për përgatitjen e planeve vjetore për punësime, trajnime, zhvillimin dhe përsosjen e personelit.

Gjatë vitit, revizorët morën pjesë on-line për mirëmbajtjen e kompetencave profesionale.


## 8 Indikatorët kryesorë të realizimit (Key Performance Indicators)

### 8.1 Efikasiteti i shpenzimeve – (Cost efficiency)

**P**ër nga aspekti financiarë i funksionimit të “M-NAV” SH.A. – Shkup, është krijuar një indikator i efikasitetit të shpenzimeve (*cost-efficiency indicator*) në trajtë të shpenzimit për njësi pagesore për fluturimin në suaza të navigacionit ajror (*en-route costs per service unit - kostot gjatë rrugës për njësi shërbimi*).

Të dhënat në tabelën 8.1 të prezantuara më poshtë ofrojnë një pasqyrë të lëvizjes së efikasitetit të shpenzimeve të "M-NAV" SH.A.- Shkup në periudhën e viteve 2009 - 2022. Nga të njëjtat mund të vërehet se me hapjen e hapësirës ajrore mbi Kosovë dhe me rritjen e trafikut në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkaj shfrytëzimit optimal të resurseve operationale, është përmirësuar dukshëm edhe

efikasiteti i shpenzimeve në "M-NAV" SH.A.- Shkup. Ky raport ndërmjet shpenzimeve totale të shërbimeve gjatë fluturimeve transitore dhe njësive të tarifimit të realizuara nga shërbimet në nivel real (EUR2009) në vitin 2017 janë reduktuar për 18,6% dhe në mënyrë plotësuese edhe për 4,8% në vitin 2018, gjë që rezultoi dhe bëri të mundur, për nga këndvështrimi i kohëzgjatjes së gjithë periudhës së dytë të referencës nga viti 2015 deri në vitin 2019, të arrihet harmonizimi në nivel lokal me objektivat e Komisionit Evropian për zvogëlimin e shpenzimeve sipas njësisë pagesore për 3.3%, mesatarisht në vit në nivel real. Kjo do të thotë se shpenzimet e ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror për të gjithë periudhën 10 vjeçare (2009-2019) janë relativisht të qëndrueshme dhe stabile, megjithëse në të njëjtën periudhë është vërejtur një rritje e trafikut prej gati 90%.



Përpara fillimit të periudhës së tretë të referencës RP3 (2020-2024), "M-NAV" SH.A. - Shkup u përpoq të ndjekë objektivin RP3 të Bashkimit Evropian në fushën e efikasitetit të shpenzimeve, siç përcaktohet në Rregulloren e BE-së me numër 2019/317, me ndryshimin vjetor të çmimeve për njësi të shërbimeve të navigacionit gjatë fluturimeve transitore prej -1.9% për vitin 2020, -1.9 % për vitin 2021, -1,9% për vitin 2022, -1,9% për vitin 2023 dhe -1,9% për vitin 2024, të shprehur në kushte reale (indeksi i çmimeve 2009).

Megjithatë, në vitin 2020 për shkak të ndikimit shkatërrues të pandemisë Covid-19 dhe rënies së trafikut ajror për 56,5% në nivel vjetor, shpenzimet e ofruesit të shërbimit nuk mund të reduktoheshin në përputhje me rënien e trafikut ajror, kështu që ky raport në vitin 2020 u ndërpre në mënyrë drastike. Edhe pse me intensitet të zvogëluar, kriza lidhur me pandeminë vazhdoi edhe në vitin 2021, dhe "M-NAV" SH.A. - Shkupi u përball me volum të reduktuar të trafikut ajror prej 30,3% krahasuar me vitin 2019, përkatësisht me periudhën para pandemisë. Shpenzimet lidhur me ofrimit të shërbimeve të fluturimeve transitore në vitin 2021 në nivel real u ulën për 9%, ndërsa shpenzimet sipas njësisë së tarifimit për një fluturim të aeroplanit (*en-route costs per service unit - kostot në rrugë për njësi shërbimi*) manifestuan ulje për 42.4%.

Për shkak të pasigurisë së vazhdueshme lidhur me trafikun ajror, gjatë tre muajve të parë të vitit 2022 dhe për shkak të ndryshimeve në rregulloren e BE-së lidhur me objektivat që lidhen me treguesin kryesor të efikasitetit, si dhe për shkak të analizës së projeksionit të ri të shpenzimeve, në negociatat me BERZH për Ri



financimin e kredisë afatgjate, në nivel vendor nuk u realizua harmonizimi formal i objektivit të lidhur me efikasitetit të shpenzimeve gjatë vitit 2022.

Duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2022, "M-NAV" SH.A. - Shkup shënon rritje të trafikut ajror dhe numrit të njësisve pagesore prej 52,4% në bazë vjetore, gjë që kontribuoi në uljen e mëtejshme të shpenzimeve për njësi të tarifimit për një fluturim të realizuar për 18,3% në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021.



**Tabela 8.1: Shpenzimet sipas njësisë pagesore (indeksi 100 gjatë vitit 2009) për fluturimet transitorë të realizuara gjatë periudhës së viteve 2009-2022**

Viti	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Inflacioni %	-0.5%	1.5%	3.9%	3.3%	2.8%	-0.5%	-0.3%	-0.2%	1.4%	1.5%	0.8%	1.2%	3.2%	14.2%
Indeksi 100-2009	100.0	101.5	105.5	108.9	112.0	111.4	111.1	110.9	112.4	114.1	115.0	116.4	120.1	137.2
Shpenzimet në milionë denarë (niveli real)	609	585	570	512	511	641	638	638	624	667	801	641	584	727
<b>Gjithsej: (% n/n-1)</b>		<b>-4.0%</b>	<b>-2.6%</b>	<b>-10%</b>	<b>-0.3%</b>	<b>25.5%</b>	<b>-0.4%</b>	<b>-0.1%</b>	<b>-2.1%</b>	<b>6.8%</b>	<b>20%</b>	<b>-20%</b>	<b>-9%</b>	<b>25%</b>

Njësi pagesore shpenzime /njësinë pagesore (mkd)	0.180	0.183	0.194	0.174	0.178	0.246	0.264	0.250	0.301	0.337	0.395	0.174	0.275	0.419
	3,385	3,198	2,941	2,944	2,869	2,605	2,417	2,551	2,078	1,979	2,027	3,683	2,122.0	1,734.5
<b>% n/n-1</b>		<b>-5.5</b>	<b>-8.0</b>	<b>0.1</b>	<b>-2.5</b>	<b>-9.2</b>	<b>-7.2</b>	<b>5.5</b>	<b>-18.6</b>	<b>-4.8</b>	<b>2.4</b>	<b>81.7</b>	<b>-42.4</b>	<b>-18.3</b>

### 8.1.1 Çmimi për njësi i "M-NAV" SH.A. – Shkup për fluturim të aeroplanëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Tabela 8.1.1: Çmimi për njësi i "M-NAV" SH.A. – Shkup për fluturim të aeroplanëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën e viteve 2014-2022



Nga grafiku i mësipërm, mund të vërehet një trend i vazhdueshëm i uljes së çmimit për njësi për fluturimet transitorë në zonën e pagesës së RMV-së në periudhën e viteve 2014-2020. Duhet theksuar se me hapjen e hapësirës ajrore mbi Kosovë në vitin 2014, u krijuan parakushtet për rritjen e trafikut ajror dhe të hyrave, të cilat realizohen nga vëllimi i shtuar i shërbimeve. Kjo nënkupton edhe rritje të stabilitetit financiar të "M-NAV" SH.A. - Shkup dhe krijimin e parakushteve për uljen e çmimit të fluturimeve transitorë në periudhën pasuese. Rrjedhimisht, gjatë periudhës së dytë referente nga viti 2015 deri në vitin 2019, kemi një trend të vazhdueshëm të uljes së çmimit të fluturimeve transitorë, kështu që në vitin 2019 kemi uljen më të madhe prej afërsisht 13% krahasuar me vitin 2018. Ky çmim është mbajtur afërsisht në të njëjtin nivel gjatë gjithë vitit 2020.

Megjithatë, situata me pandeminë Covid-19 që ka prekur të gjithë Evropën dhe më gjerë, duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2020, ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë dhe katastrofik mbi trafikun ajror dhe aviacionin në tërësi, dhe si një segment kyç i aviacionit edhe mbi ofruesit e shërbimeve të navigacionit ajror. Me këtë rast ju kujtojmë faktin se në vitin 2020, pavarësisht numrit të madh të masave antikrizë dhe të masave kufizuese të zbatuara nga "M-NAV" SH.A. - Shkup, për shkak të ndikimit katastrofik të pandemisë dhe rënies së trafikut ajror prej 56,5% në krahasim me vitin 2019, është manifestuar edhe rënie e të hyrave totale prej përafërsisht 10 milionë euro në krahasim me vitin 2019, situatë kjo e cila

përfundimisht ka rezultuar me humbje financiare të Shoqërisë prej 5,8 milionë euro. euro në baza vjetore.

Për shkak të fakteve të lartpërmendura dhe kufizimeve rrjedhëse gjatë zhvillimit të trafikut ajror, si dhe të nxitur nga nevoja për të ruajtur stabilitetin financiar dhe funksionimin e pa penguar dhe të vazhdueshëm të Shoqërisë, çmimi për njësi për shërbimet e fluturimeve transitore në vitin 2021 u rrit për 13.1% krahasuar me çmimin e njëjtë të vitit 2020. Kësaj gjendjeje i parapriu një proces konsultimi me përdoruesit e shërbimeve, të cilët u informuan në detaje për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet, shpenzimet kapitale dhe financimin e organizatës.

Në vitin 2022, çmimi për njësi për fluturimet transitore u rrit për 5.8% krahasuar me vitin 2021, bazuar në supozimet për zhvillimin dhe kohëzgjatjen e pandemisë, projektimet për një rritje të njësisive të tarifimit nga fluturimet transitore prej 29% në vitin 2022 krahasuar me planifikimet për vitin 2021. si dhe realizimin e aktiviteteve për ruajtjen e nivelit të kërkuar të sigurisë në trafikun ajror dhe të gjitha aktivitetet e tjera që janë reduktuar në minimum për shkak të pandemisë gjatë vitit 2020 dhe 2021.

Në përputhje me legjislativin e BE-së me numër 1794/2006 për përcaktimin e një sistemi të përbashkët për pagesën e shërbimeve të navigacionit ajror, si shtojcë e "Vendimit për mënyrën e përcaktimit të lartësisë së kompensimit për shfrytëzimin e shërbimeve të navigacionit ajror dhe mënyrën e arkëtimit si dhe lartësinë dhe mënyrën e përcaktimit të pjesës së kompensimit për shfrytëzimin e shërbimeve të navigacionit ajror, të miratuar nga Qeveria e RMV-së, ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 194/2019), të gjitha të ardhurat e realizuara nga fluturimet transitore në vitin 2022. në shumën e përgjithshme prej 22.478.936,27 euro janë transferuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë, një pjesë e veçantë në llogarinë e "M-NAV" SH.A. - Shkup dhe pjesa tjetër në llogarinë e Agjencisë së aviacionit civil të RMV-së nga ana e CRCO - Eurocontrol, si kompensim për financimin e shpenzimeve të shërbimeve për fluturimet transitore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Këto mjete janë ndarë në vitin 2022 nga Eurocontrol në raportin 16.80% për Agjencinë e aviacionit civil, dhe 83.20% për "M-NAV" SH.A. - Shkup (njoftim nga AAC për Eurocontrol, me numër 05-1245/1 i datës 22.12.2021).

### **8.1.2 Çmimi për njësi i "M-NAV" SH.A. – Shkup për shërbimet terminale të navigacionit ajror në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

"M-NAV" SH.A. – Shkup, si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajrorë, realizon të ardhura edhe nga ofrimi i shërbimeve të kontrollit të trafikut ajror gjatë ngritjes dhe aterritimit të aeroplanëve në dy aeroportet ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Shkup dhe në Ohër. Të hyrat nga shërbimet e terminaleve në vitin 2022 arritën pak më shumë se 140 milionë denarë, që gjithashtu paraqet rritje prej 40,16% krahasuar me të hyrat e realizuara në vitin 2021.

Çmimi për njësi për shërbimet e terminaleve që nga 1 prilli i vitit 2014 ishte 3,60 euro për ton të peshës maksimale të aeroplanit gjatë nisjes. Në ndërkohë, "M-NAV" SH.A. – Shkup e mbajti të njëjtin çmim të pandryshuar gjatë gjithë periudhës së kaluar dhe me këtë mënyrë kontribuoi së bashku me subjektet e tjera në navigacionit ajror në rritjen e kapacitetit të konkurrencës së dy aeroporteve në vend, Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit dhe Aeroportit Shën Apostulli Pali - Ohër.

Në bazë të pjesës 5.04. të Kontratës e huamarrje me BERZH për financimin e "Projektit për përmirësimin e sistemit të navigacionit ajror" në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të nënshkruar më datën 29.07.2022 si dhe me qëllim të servisimit efikas të detyrimeve sipas kontratës së njëjtë, çmimit për njësi për

shërbimet e terminaleve nga data 01.11.2022 është 4.00 euro për ton të peshës maksimale të aeroplanit gjatë nisjes së fluturimit të tij.

## 8.2 Siguria, sigurimi dhe cilësia (Safety, Security and Quality)

"M-NAV" SH.A. – Shkup i ka përfshirë të gjithë tre KPI-të e përcaktuara në rregulloret tona kombëtare dhe rregulloret SES/EC përmes rishikimit vjetor të maturimit të sistemit për menaxhim të sigurisë të udhëhequr nga ana e Eurocontrol dhe CANSO (pyetësi i plotësuar nga ana e "M-NAV" SH.A. - Shkup/SSSC) si dhe mbikëqyrjet përkatëse nga ACV. Seksionit për SSSC i ka tejkaluar me sukses të tre indikatorët si tregues të suksesit.

- Maturimi i sigurisë së sistemit për siguri (Safety Maturity);
- Vegla RAT – analiza e ngjarjeve serioze dhe të ngjarjeve më të mëdha të sigurisë;
- Kultura e drejtësisë (Just culture).

### 8.2.1 Maturimi i sigurisë së sistemit të sigurisë (Safety Maturity)

Si tregues më i rëndësishëm që ofron një pasqyrë reale të zbatimit të SMS-ve është pjesa e analizës së zbatimit dhe matjes së sistemit të sigurisë - maturimi i objektivave të arritura në pjesën e SMS në "M-NAV" SH.A. - Shkup dhe anulimi i dobësive të mundshme. Nëpërmjet pyetësorit të realizuar të maturitetit nga ana jonë, dhe të përgatitur nga Eurocontrol dhe CANSO, në tabelën 8.2 të prezantuar më poshtë mund të vërehet se "M-NAV" SH.A. – Shkup, në pajtim me Eurocontrol/CANSO SMS Standard of Excellence Measurement vlerësohet me nivel të lartë të maturimit, pothuajse në të gjitha fushat.

**Tabela 8.2: Rezultatet në pjesën e analizimit të aspektit të realizimit dhe matjes së sistemit për siguri – maturitet për tragjetet e arritura në pjesën e SMS në suaza të "M-NAV" SH.A. – Shkup për periudhën e viteve 2019-2022**

	2019	2020	2021	2022
Lowest response to any question	B	B	C	C
Number of questions at the lowest response Level	2	3	1	4
<b>Number of Questions at Each Level</b>				<b>2022</b>
Level A (Informal Arrangements)	0	0	0	0
Level B (Defined)	2	3	0	0
Level C (Managed)	2	1	1	4
Level D (Assured)	29	29	32	18
Level E (Optimised)	0	0	0	0

Në tabela 8.2 është prezantuar progresi i realizuar në raport me vitin 2019 si vit referues për matjen e arritjeve, krahasuar me vitet 2020, 2021 dhe vitin 2022.

Matjet në vitin 2022 u realizuan përmes në një pyetësor të ri on-line dhe nëpërmjet të intervistës së realizuar nga CANSO.

**Tabela 8.3: Statusi i shërbimeve në fushën e navigacionit ajror "M-NAV" SH.A. – Shkup për vitin 2022 në pajtim me standardet e Eurocontrol**

Maturity Level Achievements 2022					
					<b>2022</b>
Lowest response to any question					C
Number of questions at the lowest response Level					4
Number of Questions at Each Level					2022
Level A (Informal Arrangements)					0
Level B (Defined)					0
Level C (Managed)					4
Level D (Assured)					18
Level E (Optimised)					0
Achieved Maturity Level in each Study Area					
Study Area	Level	Responses			
	(A-E)	(A-E)			
SA1 – Safety Culture	D	D	D	D	
SA2 – Safety Policy	D	D			
SA3 – Safety Accountabilities	D	D			
SA4 – SMS Documentation	D	D			
SA5 – Safety Interfaces	D	D	D		
SA6 – Safety Risk Management	D	D	D		
SA7 – Fatigue - related Risk Management	D	D			
SA8 – Safety Reporting, Investigation & Improvement	D	D	D		
SA9 – Coordination of Emergency Response Plan	C	C			
SA10 – Safety Surveys and Audits	C	D	C		
SA11 – Change Management	D	D			
SA12 – Training and Education	D	D	D		
SA13 – Safety Communication	C	C	D	C	
SA14 – Human Performance (TA)	D				
SA15 – Safety Performance Monitoring (TA)	C				
SA16 – – Continuous Improvement (TA)	D				
<b>Overall Maturity Level</b>	D				

Raporti nga Eurocontrol dhe CANSO, përmes të cilit matet pjekuria e sistemit për menaxhim të sigurisë, ofron një pasqyrë reale të sistemit, përkatësisht të angazhimeve të deklaruara nga ana e Shoqërisë, si dhe të përkushtimit për avancimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit për menaxhim të sigurisë, në mënyrë që të mbahen të gjitha nivelet e larta të sigurisë. Nota “C”, në raportin e këtij viti, i referohet katër Study Areas (fushave të studimit), për shkak të kërkesave të reja në pajtim me legjislativin e BE-së nr. 373/2017, të cilat do të shtohen deri në muajin mars të vitit 2024, ndërsa Study Areas (fushar e studimit) të mbetura janë vlerësuar me notën “D”.

### 8.2.2 Vegla RAT (analiza e ngjarjeve serioze dhe e ngjarjeve të mëdha të sigurisë)

Analiza fillestare për çdo ngjarje A-serious (serioze), B-major (e madhe), C-significant (e konsiderueshme) konfirmohet me veglën RAT (Analiza e rrezikut) nga Eurocontrol. Për vitin 2022, të gjitha ngjarjet e kualifikuara me këtë kategori janë shqyrtuar edhe nëpërmjet mjetit RAT, për të evituar vlerësimin subjektiv – përcaktimin e shkallës së seriozitetit me shpeshtësinë (severity & Likelihood - Ashpërsia dhe gjasat). Në vitin 2022, u raportuan këto ngjarje:

- 43 operative/ATM;
- 23 teknike /CNS;
- 27 paraqitje vullnetare /voluntary;
- 2 paraqitje AIS;
- 0 paraqitje nga MOVP.

Të dhënat në tabelën 8.4 të prezantuar më poshtë i referohen numrit të përgjithshëm të operacioneve deri më datën 31.12.2022. Janë realizuar gjithsej 239.401 fluturime, duke përfshirë “approach” dhe “overflight traffic”.

Ngjarjet e sigurisë teknike këtë vit janë të një natyre shumë të ndryshme dhe në pajtim me procedurat e brendshme, të gjitha ngjarjet teknike janë hetuar në mënyrë përkatëse. Pjesa më e madhe e tyre i referohen mirëmbajtjes së sistemeve dhe pajisjeve që marrin pjesë në ofrimin e sigurt të shërbimeve në navigacionin ajror. Këto çrregullime dhe ngjarje të tjera të lidhura me CNS hetohen sipas procedurave të brendshme që rezultojnë me organizim më të mirë të brendshëm, nevojën për trajnime të specializuara, nevojën për azhurnimin e SLA ose të dokumenteve të tjera përkatëse, furnizimin e pajisjeve të reja dhe mirëmbajtjen permanente të sistemeve ekzistuese.


**Tabela 8.4: Targetet e sigurisë dhe indikatorët e “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022**

Performance Leading and Lagging Indicators	Target	Performance				Overall
		Qtr1	Qtr2	Qtr3	Qtr4	
Mandatory A Reports per 100 000 flights	25	5	17	9	12	43
Mandatory T Reports per 100 000 flights	40	5	9	5	4	23
Voluntary Reports/year	10	1	12	9	5	27

METEO Reports/year	5	/	/	/	/	0
AIS Report/ year	5	/	/	/	2	2
Safety meetings/year	3	1	2		2	5
Safety briefings/year	3	/	/			0
Safety audits per year	2	1	/	/	1	2
RAT analyzed occ/per year (A, B, C severity) SMI;RI) (AA, A, B, C severity ATM sp)	80-95%	/	3	1	2	5
Organization-specific SPIs						
Fatal accidents per 100 000 flights	Less than 0.078	/	/	/	/	0
Serious incidents per 100 000 flights (A)	Less than 2	/	/	/	/	0
Major incidents per 100 000 flights (B)	Less than 3	/	/	/	/	0
Significant incidents per 100 000 flights (C)	Less than 5	/	4	2	3	9
SMI /100 000 flights	6	1	5	3	2	11
Airspace infringement/ annual basis	3				2	2
Bird strike per 1000 flights	Less than 0.7	1	3	4	1	9
Runway incursion per 4000 flights	Less than 2	/	/	/	/	0
Runway excursion per 4000 flights	Less than 2	/	/	/	/	0

Në pjesën e Mandatory dhe Voluntary Reports/ per year, gjatë vitit 2022 është tejkuluar numri i pritur i paraqitjeve të detyrueshme dhe të paraqitjeve vullnetare.

**Tabela 8.5: Numri dhe lloji i ngjarjeve të sigurisë në “M-NAV” SH.A. – Shkup për periudhën e viteve 2017-2022**



### 8.2.3 Kultura e drejtësisë (Just Culture)

Gjatë vitit 2022 janë shqyrtuar dy ngjarje, për të cilat Just Culture Committee (Komisioni për kulturë të drejtësisë) ka marrë vendime në përputhje me Politikën e kulturës së drejtësisë. Pas mbajtjes së mbledhjeve të JSS-së, gjithashtu u ndërморën masa për ndryshimin e Politikës në fusha të caktuara me qëllim të përmirësimit të procesit të vendimmarrjes. Në vitin 2022 u azhurnua Politika e kulturës së drejtësisë.

### 8.3 Kapaciteti (Capacity)

Kapacitetet ekzistuese ishim më shumë se të mjaftueshme për ofrimin e shërbimit të kërkesave nga ana e shfrytëzuesve të hapësirës ajrore gjatë vitit 2022.

**Tabela 8.6: Kapaciteti i “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022**

Skopje ACC	Traffic (% of 2019)	En-route Delay (min. per flight)		Capacity	
		All reasons	ACC Reference Value	Capacity Gap?	Baseline
Year	111%	0.13	0.03	No	70
Summer	110%	0.17		No	70
<b>Summer 2021 performance assessment</b>					
The average delay per flight was 0.17 minutes per flight in Summer 2022.					
<b>Operational actions</b>			<b>Achieved</b>	<b>Comments</b>	
6 additional ATCOs			Yes		
VHF replacement			Yes		

IFR Movements (Thousands)		2019	2020*	2021	2022	2023	2024*	2025	2026	2027	2028*	2029	AAGR 2023-2029
North Macedonia	High	.	.	.	.	267	284	296	308	319	330	339	5,5%
	Base	223	95	155	234	263	277	284	289	295	300	304	3,8%



Low	.	.	.	.	258	269	271	270	269	270	269	2,1%
-----	---	---	---	---	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	------

#### 8.4 Vonesa te fluturimet transitore (Delay)

Tabela 8.7: Vlerat referente për vonesën te fluturimet transitore për të gjithë ofruesit e shërbimeve në navigacionin ajror gjatë periudhës verore të vitit 2022 krahas situatës së vitit 2019.

##### Delay summer 2022 vs 2019

	April	May	June	July	August	September	October	Total
<b>delay 2022</b>		236	4988	4157	11915	8194		29490
No. of flights	16117	22424	26103	28599	27334	22597	22456	165630
average delay per flight	0,00	0,01	0,19	0,14	0,43	0,36	0,00	0,17
<b>delay 2019</b>	217	675	4288	4353	281	2758		12572
No. of flights	16566	23058	26777	29763	29917	26356	22020	152437
average delay per flight	0,01	0,03	0,16	0,15	0,01	0,10	0,00	0,08
delay 2022/19 (%)		-66%	18%	-6%	4200%	260%		112%

## 9 Raportet e reviduara financiare të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022

### Raport për gjendjen financiare

	Shë nime	31 dhjetor 2022	Në mijë denarë 31 dhjetor 2021
<b>MJETET</b>			
<b>Mjetet jo rrjedhëse</b>			
Patundshmëritë, instalimet dhe pajisjet	5	647,236	522,694
Mjetet jo materiale	6	6,876	7,557
		<b>654,112</b>	<b>530,251</b>
<b>Mjetet rrjedhëse</b>			
Rezervat	8	12,395	13,086
Kërkesat për më shumë tatim të paguar të fitimit		17,881	17,881
Kërkesat nga blerësit dhe kërkesat tjera	9	201,104	145,665
Mjetet monetare dhe ekuivalentet	10	484,760	442,704
		<b>716,140</b>	<b>619,336</b>
<b>Gjithsej mjete</b>		<b>1,370,252</b>	<b>1,149,587</b>
<b>KAPOTALI DHE OBLIGIMET</b>			
Kapitali i aksionarëve	11	1,552,034	1,552,034
Diskonti i aksioneve të emetuara		(388,141)	(388,141)
Rezervat ligjore	11	1,873	-
Humbja e akumuluar		(131,690)	(266,774)
<b>Gjithsej kapitali</b>		<b>1,034,076</b>	<b>897,119</b>
<b>Obligimet</b>			
<b>Obligimet jo rrjedhëse</b>			
Huazimet	12	183,749	127,520
Donacionet e kufizuara	13	8,395	10,287
Rezervimet	14	6,130	6,278

		<b>198,274</b>	<b>144,085</b>
<b>Obligimet rrjedhëse</b>			
Pjesa afatshkurtre e huazimeve	12	23,116	35,192
Obligimet ndaj furnizuesve dhe obligimet rrjedhëse	15	114,786	73,191
		<b>137,902</b>	<b>108,383</b>
<b>Gjithsej obligime</b>		<b>336,176</b>	<b>252,468</b>
<b>Gjithsej kapitali dhe obligimet</b>		<b>1,370,252</b>	<b>1,149,587</b>

## Raport për fitimin gjithë përfshirës

	Shënimi	Në mijë denarë Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	
		2022	2021
Të hyra nga shitja	16	1,301,727	822,641
Të hyra të tjera operative	17	3,862	6,102
<b>Gjithsej të hyra</b>		<b>1,305,589</b>	<b>828,743</b>
Shpenzime për mirëmbajtje materiale	18	(70,180)	(45,796)
Shpenzimet për të punësuarit	19	(971,313)	(650,678)
Amortizimi i depreciacionit	5, 6	(35,107)	(35,842)
Shpenzime të tjera afariste	20	(79,247)	(49,837)
<b>Fitimi nga aktivitetet afariste</b>		<b>149,742</b>	<b>46,590</b>
Të hyrat financiare	21	1,728	1,473
Shpenzimet financiare	21	(14,513)	(10,610)
<b>Shpenzimet financiare, neto</b>		<b>(12,785)</b>	<b>(9,137)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>136,957</b>	<b>37,453</b>
Tatimi i fitimit	22	-	-
<b>Fitimi për vitin</b>		<b>136,957</b>	<b>37,453</b>
Fitimit i mbetur gjithë përfshirës për vitin		-	-
<b>Fitimit i përgjithshëm gjithë përfshirës për vitin</b>		<b>136,957</b>	<b>37,453</b>

## Raporti për ndryshimet e kapitalit

	Në mijë denarë				
	Kapitali aksionar	Diskonti i aksioneve të emetuara	Rezervat	Fitimi / humbja e akumuluar	Gjithsej
<b>Më 1 janar të vitit 2022</b>	<b>1,522,034</b>	<b>(388,141)</b>	<b>-</b>	<b>(266,774)</b>	<b>897,119</b>
<i>Transaksione me pronarët</i>					
Përcaktimi i rezervave (Shënimi 11)	-	-	1,873	(1,873)	-
<b>Gjithsej transaksione me pronarët</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,873</b>	<b>(1,873)</b>	<b>-</b>
Fitimi gjatë vitit	-	-	-	136,957	136,957
Fitimi tjetër gjithë përfshirës	-	-	-	-	-
<b>Fitimi i përgjithshëm gjithë përfshirës</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>136,957</b>	<b>136,957</b>
<b>Më 31 dhjetor të vitit 2022</b>	<b>1,522,034</b>	<b>(388,141)</b>	<b>1,873</b>	<b>(131,690)</b>	<b>1,034,076</b>
<b>Më 1 janar të vitit 2021</b>	<b>1,522,034</b>	<b>(388,141)</b>	<b>54,070</b>	<b>(358,297)</b>	<b>859,666</b>
<i>Transaksione me pronarët</i>					
Përcaktimi i rezervave (Shënimi 11)	-	-	(54,070)	54,070	-
<b>Gjithsej transaksione me pronarët</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(54,070)</b>	<b>54,070</b>	<b>-</b>
Fitimi gjatë vitit	-	-	-	37,453	37,453
Fitimi tjetër gjithë përfshirës	-	-	-	-	-
<b>Fitimi i përgjithshëm gjithë përfshirës</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>37,453</b>	<b>37,453</b>
<b>Më 31 dhjetor të vitit 2021</b>	<b>1,522,034</b>	<b>(388,141)</b>	<b>-</b>	<b>(266,774)</b>	<b>897,119</b>

## Raport për rrjedhat monetare

	Shënimi	Në mijë denarë	
		Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	2022
<b>Aktivite operative</b>			
Fitimi për vitin		136,957	37,453
<u>Korrigjime për:</u>			
Amortizimi dhe depreceacioni	5, 6	35,107	35,842
Çregjistrimi i patundshmërive, instalimeve dhe pajisjeve	20	218	-
Rezervime për leverdi të punonjësve	14	705	531
Të hyra nga donacionet	17	(1,892)	(1,761)
Korrigjimi i vlerës së kërkesave nga blerësit	20	6,879	1,757
Çregjistrimi i kërkesave nga blerësit	20	3,736	100
Të hyra nga normat e interesit	21	(1,098)	(1,083)
Shpenzime sipas normës së interesit	21	11,124	8,883
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues		192,096	81,723
Mjetet e kufizuara monetare		(101,129)	43,609
Rezervat		691	324
Donacionet		-	206
Rezervimet		(853)	(338)
Kërkesat nga blerësit dhe kërkesat tjera		(65,316)	(19,272)
Obligimet ndaj furnizuesve dhe obligimet tjera		41,595	61,739
Fitimi operativ pas ndryshimeve në kapitalin qarkullues		67,084	167,991
Normat e paguara të interesit	12, 21	(11,124)	(8,498)
Normat e pranuar të interesit	21	1,098	1,083
Tatimi i paguar i fitimit		-	-
<b>Rrjedhat neto financiare nga aktivitetet operative</b>		<b>55,960</b>	<b>160,576</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>			
Furnizimi i patundshmërive, pajisjeve dhe i mjeteve jo materiale		(159,186)	(16,913)

<b>Rrjedhat neto monetare (të shfrytëzuara për) aktivitetet investuese</b>	<b>(159,186)</b>	<b>(16,913)</b>
<b>Aktivitetet financiare</b>		
Të hyra sipas kredive	241,321	16,825
Kredi të paguara	(197,168)	(34,939)
<b>Rrjedhat neto monetare nga / (zë shfrytëzuara) për aktivitete financiare</b>	<b>44,153</b>	<b>(18,114)</b>
<b>Neto ndryshime të mjeteve monetare</b>	<b>(59,073)</b>	<b>125,549</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentet gjatë fillimit	434,867	309,319
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet në fund</b>	<b>10</b>	<b>375,794</b>
		<b>434,868</b>

**R**aportet e lartpërmendura financiare janë përpiluar përfundimisht me gjendjen e konstatuar më datën 31.12.2022 në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Njoftim Financiar (SNNJF), të shpallura në Republikën e Maqedonisë së Veriut në Rregulloren për kontabilitet (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 159/09) të zbatueshme nga data 01.01.2010, duke i përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Interpretimet e botuara nga ana e Këshillit për Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (KSNK) dhe Komitetit për interpretim të Standardeve Ndërkombëtare për njoftime financiare (KISNNJF), në mënyrë suksese.

Raportet financiare janë të përpiluara me metodën e vlerës së furnizimit dhe parimit të vazhdimësisë së funksionimit.

Këto raporte financiare i përfshijnë kërkesat, obligimet, rezultatet operative, ndryshimet në kapitalin dhe rrjedhat monetare të Shoqërisë si entitet i veçantë.

Bazat për matjen e tyre, në mënyrë të detajuar janë të sqaruar në suaza të Shënimeve përcjellëse të Raportit nga revizori i pavarur “Grand Thornton Shkup”.

(Raporti i Revizorit të pavarur “Grand Thornton Shkup” me raportet financiare të “M-NAV” SH.A. – Shkup për vitin 2022 janë të dhëna si shtojca).

**Pajtimin e ka dhënë:**

**Извршен директор за финансиски работи, правни работи, развој и  
ИНВЕСТИЦИИ**

**Drejtori Ekzekutiv për çështje financiare, ligjore, zhvillim dhe investime**

**Dr. Hasim Deari**

**Претседател на Управен одбор**

**Kryetar i Këshillit Drejtues**

**Fahrudin Hamidi**